# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6108
E martë, 8 shtator 2020
çmimi 0.40 €


## Rënie e lehtë e rasteve të reja me Covid në Kosovë

FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT FAQE 4-5

# THAÇI: NË SHTËPINË E BARDHË, SHTETI I KOSOVËS U FUQIZUA NDËRKOMBËTARISHT



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, marrëveshjen e 4 shatorit në Uashington e ka vlerësuar ndërmarrje diplomatike më serioze të ShBA-së në Ballkan. Në një konferencë për media mbajtur të hënën, ai ka thënë se u vërtetua se në Shtëpinë e Bardhë ka vetëm fuqizim ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe jo thika mbi hartën e Kosovës. Shefi i shtetit i ka ftuar që të kërkojnë falje publike ata që kanë thurur konspiracione për këtë marrëveshje. Presidenti Thaçi sërish ka ftuar spektrin politik që të bëhen bashkë për këtë proces të rëndësishëm për shtetin e Kosovës

KOSOVA DHE SERBIA KANË MBAJTUR TAKIMIN E DYTË TË NIVELIT TË LARTË POLITIK NË BRUKSEL

# Në Bruksel hapet tema e asociacionit




Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se është arritur përparim në draftimin e marrëveshjes finale në takimin në Bruksel me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Pas takimit, në të cilin është diskutuar për asociacionin e komunave serbe dhe për zgjidhjen e kërkesave të ndërsjella financiare dhe pronësore, Hoti ka thënë se çdo gjë që diskutohet është pjesë e marrëveshjes finale. Takimi i radhës në dialogun në nivelin politik, ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe presidentit të Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, është caktuar të mbahet më 28 shtator FAQE 3



## 67 për qind e kaluan testin e maturës në afatin e parë

FAQE 7

## OPINION

**A MUND TË JETË KOMANDANT I UÇK-së AI QË E QUAJTI ORGANIZATË TERRORISTE?!** F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE

**PDK-ja KËRKON SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI** F. 7

**NJË PERSON ME SYZE E MASKË DORËZOI 4 000 DOSJE TË GJYKATËS SPECIALE NË ZYRAT E OVLUÇK-së** F. 5

## EKONOMI

**KRYETARJA E KUVENDIT PRANON RAPORTIN VJETOR TË AUDITIMIT PËR VITIN 2019** F. 8

**'SHELL'-i DHURON 27 LAPTOP PËR SHKOLLËN FILLORE 'FAIK KONICA'** F. 8



## KULTURË

**KRIZA JONË E LEXIMIT** F. 12



Lulëzim ETEMAJ

## SPORT

**NJOHËSIT E FUTBOLLIT: BERISHA KISHTE TË DREJTË NË REAGIMIN NDAJ CHALLANDESIT** F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
KOLEGJI BIZNESI · BIZNESI COLLEGE · PRISHTINË 2004
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

## Navalny del nga koma



BERLIN, 7 SHTATOR - Spitali gjerman që po trajton liderin opozitar rus, Aleksei Navalny, ka thënë se gjendja e kritikut të Kremlinit është "përmirësuar" dhe se ai është "duke iu përgjigjur stimujve verbalë".
Spitali Charite në Berlin ka thënë përmes një deklarate të hënën se 44-vjeçari është "larguar nga koma e induktuar" dhe se "po largohet nga ventilimi mekanik".
Megjithatë, spitali ka thënë se është shumë herët "për t'i vlerësuar efektet potenciale afatgjatë të helmimit të tij të rëndë".
Gjermania ka thënë se Navalny është helmuar muajin e kaluar në Siberi me agjent nervor të kategorisë ushtarake të periudhës sovjetike, Noviçok.
Navalny, politikan dhe hulumtues i korrupsionit, njëherësh një prej kritikëve më të mëdhenj të presidentit rus Vladimir Putin, është sëmurë më 20 gusht në avion, derisa ka qenë duke udhëtuar nga Siberia në Moskë.
Aeroplani është detyruar të bëjë ulje emergjente në qytetin Omsk, në mënyrë që Navalny të dërgohet në spital. Pas spitalit siberian, ai më vonë është transferuar në një spital në Berlin, ku mjekët javën e kaluar kanë thënë se ka mundësi që Navalny është helmuar.
Ivan Zhdanov, përkrahës i Navalnyt, ka thënë përmes një postimi në "Twitter" se agjenti nervor Noviçok mund të kontrollohet vetëm nga agjencitë ruse të inteligjencës.

# Nis sesioni i ri parlamentar në Shqipëri



Tiranë, 7 shtator - Këtë të hënë ka nisur zyrtarisht seanca plenare dhe sesioni i ri parlamentar 2020-2021. Që në nisje të seancës, në sallën e Kuvendit u vendos himni kombëtar, ndërsa deputetët u ngritën në këmbë dhe kënduan vargjet e këngës simbol të shqiptarëve. Në sallë pjesëmarrësit mban maska si dhe u zbatua distanca fizike mes tyre.
Kreu i parlamentit, Gramoz Ruci, ka përshëndetur marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Në hapje të këtij sesioni, dëshiroj ta përshëndes marrëveshjen ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë, të firmosur në praninë e presidentit të ShBA-së, Donald Trump. Kjo marrëveshje i hap rrugë marrëveshjes përfundimtare dhe njohjes së ndërsjellë. Natyrisht, marrëveshja e Uashingtonit e 4 shtatorit nuk është gjithçka do të dëshironim ne shqiptarët. Por, të paktën, për momentin, procesi është po aq i rëndësishëm sa edhe produktet e kësaj marrëveshjeje. Hyrja e flamurit e Republikës së Kosovës në Shtëpinë e Bardhë dhe hapja e dosjes së Kosovës në tryezën e punës së presidentit të Shteteve të Bashkuara është garanci e një procesi pa kthim prapa. Le të kontribuojmë të gjithë që ajo dosje të mos hiqet nga tryeza e presidentit amerikan, pa u zgjidhur përfundimisht njohja e Kosovës", ka thënë Ruçi.

# Australia mund ta nisë vaksinimin për koronavirus në janar



CANBERRA, 7 SHTATOR - Australia ka njoftuar se do të sigurojë 85 milionë doza të vaksinës për koronavirus, nëse dy prova të saj rezultojnë të suksesshme.
Kryeministri Scott Morrison ka pohuar se vendi i tij ka arritur dy marrëveshje për doza pa pagesë, që do të jepeshin në vitin 2021, nëse miratohen për përdorim. Ai ka thënë se 25 milionë njerëzit e Australisë do të mund ta nisin vaksinimin në janar, por shtoi se "nuk ka garanci" për këtë.
Njëra vaksinë është nga Universiteti Oxford dhe kompania farmaceutike "AstraZeneca", ndërsa tjetra është lokale, nga Universiteti Queensland. E para është në fazën e tretë dhe të fundit të testimit, e dyta është në fazën e parë.
Të dyja ka shumë të ngjarë të kërkojnë që njerëzit të marrin nga dy doza.
Australia ka regjistruar më shumë se 26 000 raste me koronavirus dhe 769 viktima, shumica prej tyre në dy muajt e fundit.
Qeveria e Australisë ka njoftuar se imunizimi nuk do të jetë i detyrueshëm, porse do të inkurajohet fuqishëm.
Morrison ka thënë se Australia gjithashtu mbetet e përkushtuar për ta siguruar qasjen në vaksina për fqinjët e saj në Paqësor dhe Azinë Juglindore.

## Gjykata saudite ndryshon dënimet për vrasësit e Khashoggit

RIAD, 7 SHTATOR - Një gjykatë në Arabinë Saudite ka zëvendësuar dënimet me vdekje ndaj pesë të dënuarve për vrasjen e kolumnistit Jamal Khashoggi më 2018, ka raportuar media shtetërore.
Prokurori Publik ka thënë se të dënuarit me vdekje tani do të ndëshkohen me 20 vjet burgim pasi familja e Khashoggit i ka falur ata.
Tre të tjerë do të dënohen mes shtatë deri në 10 vjet burgim.
Khashoggi, kritik i ashpër i qeverisë saudite, është vrarë brenda konsullatës së Mbretërisë Saudite në Stamboll nga një ekip i agjentëve saudite.
Qeveria saudite ka thënë se Khashoggi është vrarë në një "operacion mashtrues" derisa një vit më vonë prokurori i këtij shteti ka gjykuar 11 individë të paidentifikuar.
Fillimisht, pesë prej tyre janë ndëshkuar me vdekje për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në vrasje, tre janë dënuar me burgim për mbulim të krimit, derisa të tjerët ishin shfajësuar.
Ky gjyq ishte konsideruar "antitezë e drejtësisë" nga një përfaqësues special i Kombeve të Bashkuara, që ka gjetur se Khashoggi ka qenë "viktimë e një ekzekutimi të qëllimshëm" mbrapa të cilit qëndron shteti saudit.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kosova dhe Serbia kanë mbajtur takimin e dytë të nivelit të lartë politik në Bruksel

# Në Bruksel hapet tema e asociacionit




Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se është arritur përparim në draftimin e marrëveshjes finale në takimin në Bruksel me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Pas takimit, në të cilin është diskutuar për asociacionin e komunave serbe dhe për zgjidhjen e kërkesave të ndërsjella financiare dhe pronësore, Hoti ka thënë se çdo gjë që diskutohet është pjesë e marrëveshjes finale. Takimi i radhës në dialogun në nivelin politik, ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe presidentit të Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, është caktuar të mbahet më 28 shtator

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë deklaruar të hënën se i kanë përafruar qëndrimet për temën e të zhvendosurve, të zhdukurve si dhe atë për bashkëpunim ekonomik. Pas takimit të dytë të nivelit të lartë politik, ata kanë konfirmuar se gjatë takimit në Bruksel kanë hapur dy tema të reja: Asociacionin e komunave serbe dhe zgjidhjen e kërkesave të ndërsjella financiare dhe pronësore.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka vlerësuar se është bërë përparim në draftimin e marrëveshjes finale që, sipas tij, duhet të jetë ligjërisht e obligueshme. "Unë me kënaqësi e them që është bërë përparim në draftimin e marrëveshjes finale në mes të dy shteteve për normalizim të plotë të marrëdhënieve. Do të vazhdojmë në takime të tjera, me tema tjera që duhet të adresohen. Çdo që e diskutojmë është pjesë e marrëveshjes finale, duke vlejtur gjithmonë parimi që ne nuk pajtohemi asgjë derisa nuk pajtohemi për marrëveshjen finale", ka thënë Hoti para gazetarëve në Bruksel.

Ai ka deklaruar se ka koordinim të plotë mes ShBA-së dhe BE-së për këtë proces. "Çështja e Kosovës është ndarë. Në takimin me Lajçakun dhe Palmerin më është thënë se ekziston koordinim jo i ngushtë, por i plotë për procesin e dialogut në mes të BE-së dhe ShBA-së. Kemi marrëveshjen në Uashington për normalizim të pjesës ekonomike me disa elemente politike. Takimi i sotëm, progresi që është bërë, neve na afron më afër marrëveshjes finale për njohje reciproke", ka shtuar ai.

Hoti ka bërë me dije se Kosova është në këtë proces për të treguar konstruktivitet. "Ne jemi në Bruksel vetëm për këtë çështje, për të treguar konstruktivitetin tonë si qeveri, që jemi të gatshëm të lëvizim para. Dëshiroj të falënderoj zotin Borrell e zotin Lajçak dhe punën e dy ekipeve tona për përafrimin e qëndrimeve", ka deklaruar ai.

Kurse presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar se në kuadër të dialogut tani po trajtohen çështje të vështira dhe se palët kishin pikëpamje të ndryshme. Kjo, sipas tij, bën që bisedimet të jenë më të komplikuara dhe më të vështira. Sipas Vuçiqit, pala serbe ishte ajo që hapi çështjen e asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe se për këtë temë do të diskutohet edhe në raundin e ri të bisedimeve. "Ne kemi rënë dakord për një mekanizëm për përcaktimin e regjistrave të personave të zhvendosur dhe personave të zhdukur dhe për qasje në të gjitha arkivat. Prishtina do të miratojë një ligj mbi kthimin e personave të zhvendosur, i cili është një hap i rëndësishëm, megjithëse ne mbetemi të rezervuar për rezultatet në praktikë", ka deklaruar presidenti serb.

Ai ka thënë se sapo të formohet qeveria e re serbe, ai para Kuvendit do ta paraqesë temën e Kosovës. "Sapo të formohet një qeveri e re dhe Kuvendi të fillojë të punojë me kapacitet të plotë, ne do ta paraqesim para Kuvendit temën e Kosovës. Ne e kemi pasur atë në Kuvend 5-6 muaj më parë, por ne duam që të gjithë ata që marrin pjesë në bisedime t'i paraqesin Kuvendit se çfarë po diskutohet", ka deklaruar Vuçiqi.

Takimi i radhës në dialogun në nivelin politik, ndërmjet kryeministrit të Kosovës dhe presidentit të Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, është caktuar të mbahet më 28 shtator.

## Lajçak: U arrit përparim i plotë në disa çështje

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë të hënën se në dialogun e zhvilluar në mes të përfaqësuesve të këtyre dy shteteve në Bruksel është arritur përparim i plotë në diskutimet rreth bashkëpunimit ekonomik dhe çështjes së personave të pagjetur dhe të zhvendosur. "Është e rëndësishme që të dy liderët këtë mëngjes, teksa kanë ardhur nga takimet e Shtëpisë së Bardhë, kanë konfirmuar se janë të lidhur me prioritetet e integrimit në Bashkimit Evropian dhe në vazhdimin e punës për dialogun Beograd - Prishtinë, të ndërmjetësuar nga BE-ja", ka thënë Lajçak pas takimit. Sipas tij, në takimin e së hënës për herë të parë është diskutuar edhe për marrëveshjen gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese, për çështjet e komuniteteve joshumicë dhe për pretendimet e përbashkëta financiare dhe pronësore. "Ky ka qenë këmbimi i parë që na ka lejuar neve t'i definojmë hapat e ardhshëm të diskutimeve tona. Takimi ynë i radhës do t'u dedikohet këtyre temave", ka deklaruar Lajçak.

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT

# THAÇI: NË SHTËPINË E BARDHË SHTETI I K



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, marrëveshjen e 4 shatorit në Uashington e ka vlerësuar ndërmarrje diplomatike më serioze të ShBA-së në Ballkanin. Në një konferencë për media mbajtur të hënën, ai ka thënë se u vërtetua se në Shtëpinë e Bardhë ka vetëm fuqizim ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe jo thika mbi hartën e Kosovës. Shefi i shtetit i ka ftuar që të kërkojnë falje publike ata që kanë thurur konspiracione për këtë marrëveshje. Presidenti Thaçi sërish ka ftuar spektrin politik që të bëhet bashkë për këtë proces të rëndësishëm për shtetin e Kosovës

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se marrëveshja e 4 shtatorit në Shtëpinë e Bardhë ka konfirmuar përkushtimin e ShBA-së për përkrahjen e Kosovës.

Në një konferencë për media, ai ka thënë se marrëveshja për normalizim ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë është ndërmarrja diplomatike më serioze e ShBA-së në Ballkan. Ai e ka falënderuar administratën Trump që gjatë këtyre viteve i ka qëndruar pranë shteti të Kosovës. "Mirënjohje për ShBA-në që gjithmonë na ka qëndruar pranë. Në të gjitha takimet që kam zhvilluar katër vjet me presidentin Trump më ka folur për një vend dhe popull të mrekullueshëm. Javën e kaluar ishte një konfirmim i kësaj përkrahje. Ndihem i lumtur dhe krenar që pas përpjekjeve dhe punës së përbashkët për dy vjet me presidentin Trump, të premten arritëm të formalizohen këto përpjekje", ka deklaruar ai.

Shefi i shtetit ka përmendur edhe pengesat që ka pasur ky proces. "Ishte ndërmarrja diplomatike më serioze e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këto dy dekada për Ballkanin Perëndimor. Gjatë këtij procesi jo të lehtë, në fakt shumë të vështirë, hasem në vështirësi, akuza, pengesa, konspiracione të shumta nga

# Osmani: Bashkëpunimin me LV-në do ta konkretizoj më vonë

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, është ndarë përfundimisht me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Ajo është shprehur se është shumë vonë për partinë e Isa Mustafës të kërkojë më mbështetje nga ajo në rast të zgjedhjeve të parakohshme, duke e lënë të hapur mundësinë për bashkëpunim me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

"Natyrisht se po. Përgjigjja konkrete është vendimi i tyre i 20 qershorit për të më përjashtuar. Aty ka përfunduar gjithçka", ka thënë ajo.

Osmani pasi ka marrë pjesë në një aktivitet të hënën për ndihmë juridike falas dhe para gazetarëve ka thënë se ky bashkëpunim do të konkretizohet më vonë. "Ne jemi në kontakt dhe bisedojmë për tema të ndryshme të bashkëpunimit. Se si do të konkretizohet ky bashkëpunim në të ardhmen do t'ju njoftojnë në momentin që do të konkretizohet", ka është shprehur Osmani.

Disa muaj më parë Vjosa Osmani është shkarkuar nga detyra e saj si nënkryetare e LDK- së dhe anëtare e Këshillit të Përgjithshëm pasi, siç u tha nga kryesia e partisë, nuk kishin qëndrime të njëjta. /Ksp/



# OSOVËS U FUQIZUA NDËRKOMBËTARISHT



shumë anë. Me formalizimin në Shtëpinë e Bardhë, të gjitha këto u treguan të rrejshme, të paqëndrueshme dhe paragjykuese", ka thënë Thaçi. Ai i ka kritikuar ata që kanë thurur konspiracione rreth kësaj marrëveshje. "Ne nuk do t'i humbnim vitet që i kemi humbur me konspiracione dhe paragjykime. U pa që nuk ka pasur thika në Shtëpi të Bardhë, harta dhe as ndarje të Kosovës në Shtëpi të Bardhë, por ka respektim të shtetit dhe fuqizim ndërkombëtar të shtetit tonë", ka deklaruar.

Sipas presidentit, ata që i kanë potencuar këto gjëra duhet të kërkojnë falje para qytetarëve të Kosovës. "Prandaj ata që kanë hedhur gjëra të rrejshme, i ftoj që t'u kërkojnë falje qytetarëve të Kosovës për injorancën që kanë treguar, konfuzionin dhe mashtrimin që kanë pretenduar t'ua sjellin qytetarëve të Kosovës", ka thënë Thaçi.

I pyetur se si ndihet që nuk mori pjesë në takimin në Uashington, ai ka deklaruar se më e rëndësishme është substanca e marrëveshjes sesa prania fizike. "Për mua me më rëndësi sesa prania fizike janë shpirti dhe substanca e marrëveshjes. Kosova mund të ketë sukses me lidershipin e ShBA-së, me atë që mund të arrihet në Shtëpinë e Bardhë. Ndihem tepër mirë që ranë ato flluska të gënjeshtra që u përhapën për thika e për harta. Ku mbetën ato konspiracione e akuza. Ata duhet t'u kërkojnë falje qytetarëve për atë konfuzion që e krijonin në opinion politik", është shprehur ai.

Presidenti Thaçi përsëri ka ftuar lidershipin e Kosovës për unitet rreth procesit të dialogut. "Nuk mund të bëhet asnjë hap më tutje pa unitet politik pozitë-opozitë, sepse vendi është i të gjithëve. Vetëm kontributi i përbashkët i të gjithëve mund të rezultojë me sukses për vendin tonë, veçanërisht në procesin për implementimin e kësaj marrëveshjeje. Ne gjithë kemi kërkuar çdoherë të ketë rol udhëheqës lidershipi i ShBA-së. Kjo ka ndodhur. Nuk bën të lejojmë që mentaliteti tribal të ndikojë në vonesa që Kosova po i paguan shumë shtrenjtë", ka deklaruar Thaçi.

### Thaçi: Njohja nga Izraeli nuk e cenon partneritetin me Turqinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se njohja e Kosovës nga Izraeli ka ndodhur në kohën më të duhur. Sipas tij, kjo është një e arritur e madhe dhe strategjike për vendin. "Se pse është vonuar njohja, është çështje tjetër dhe e kuptueshme për interesin e Izraelit. Se a do ta njihte Kosovën Izraeli, ka qenë e njohur botërisht se kjo do të ndodhte. Megjithatë, kjo ka ndodhur në kohën më të duhur", ka deklaruar Thaçi.

Ai ka deklaruar se kjo njohje nuk do ta cenojë partneritetin me Turqinë. Madje Thaçi ka treguar se për këtë çështje ka biseduar përmes telefonit me presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. "Për hir të transparencës, dëshiroj të informoj edhe për shqetësimin që kemi marrë nga Liga Arabe dhe presidenti Erdogan sa i përket njohjes së ndërsjellë Izrael - Kosovë. Unë jam në kontakt me presidentin Erdogan. Kemi diskutuar në telefon. Kjo njohje nuk do ta cenojë në asnjë rrethanë partneritetin miqësor dhe vëllazëror me Turqinë. Tani do të kemi aleatë edhe më të mëdhenj dhe më të fuqishëm në rrafshin e fuqizimit global të shtetit të Kosovës", ka deklaruar Thaçi.

Marrëveshja e 4 shtatorit parasheh bashkëpunim ekonomik mes dy vendeve. Me këtë marrëveshje palët janë zotuar se do të zbatojnë një sërë marrëveshjesh të arritura tashmë, siç është ajo për autostradën në mes të Kosovës dhe Serbisë, ajo për hekurudhat dhe për linjën ajrore. Po aty parashihet që Kosova dhe Serbia t'i përshpejtojnë përpjekjet për të lokalizuar dhe identifikuar mbetjet e personave të humbur. Në bazë të marrëveshjes, Kosova dhe Serbia do t'i bashkohen "zonës së mini-Schengenit", që është krijuar më 2019 dhe ku tashmë marrin pjesë Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Kosova, sipas marrëveshjes, është pajtuar që brenda një viti të mos kërkojë anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Serbia, në anën tjetër, është pajtuar që brenda një viti ta ndalë fushatën për çnjohjen e pavarësisë së Kosovës. Sa i përket Liqenit të Ujmanit, në marrëveshje thuhet se palët do të punojnë me Departamentin Amerikan të Energjisë për një studim fizibiliteti, me qëllim të përdorimit të përbashkët të këtij liqeni, si furnizues i sigurt i ujit dhe energjisë.

# Një person me syze e maskë dorëzoi 4 000 dosje të Gjykatës Speciale në zyrat e OVLUÇK-së

**Prishtinë, 7 shtator** - Një pako me 4 000 dosje të Gjykatës Speciale ka arritur të hënën në zyrat e OVLUÇK-së në Prishtinë. Deri më tani nuk dihet kush e solli, megjithatë brenda pakos kishte një letër në të cilën shkruante se gjatë ditëve në vijim do të arrijnë edhe 7 000 dosje të tilla. Kështu ka thënë kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, në një konferencë për media. "Dosjen e ka sjellë dikush sot në orën 09:15. Ka qenë me syze, me maskë dhe kapelë. Vetëm e ka lënë pakon dhe ka ikur. Në fillim jemi frikësuar se çka mund të ketë, pasi e kemi hapur me kujdes e kemi parë që ka material të Gjykatës Speciale", ka thënë Gucati. Ai ka shtuar se këto dosje kanë dalë nga Gjykata Speciale. "Është material i Gjykatës Speciale që ka dalë prej saj. Dikush e ka sjellë në organizatë. Ka emra të dëshmitarëve. Janë nënshkrime të prokurorëve të huaj dhe atyre serbë që kanë bashkëpunuar me Specialen", ka thënë Gucati, duke treguar edhe për letrën që gjendej brenda pakos. "Në pako ishte një letër në të cilën shkruante se gjatë ditëve në vijim do t'i sjellin edhe 7 000 dosje të tilla", ka deklaruar Gucati.



Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Pesë të vdekur, 97 të shëruar dhe 85 raste të reja me Covid

# Rënie e lehtë e rasteve të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur pesë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po sipas këtij instituti, gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar 85 raste të reja pozitive me Covid dhe janë shëruar 97 persona. "Numri total i rasteve pozitive është 14 204 raste nga 54 443 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 568 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 97 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 10 643 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 2 993", ka njoftuar IKShPK-ja




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 7 shtator - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka publikuar të dhënat e fundit rreth situatës me Covid-19 në vendin tonë. Në 24 orët e fundit janë regjistruar 85 raste të reja pozitive me Covid, pesë persona kanë vdekur dhe 97 janë shëruar. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 432 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 85 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 5 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 14 204 raste nga 54 443 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 568 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 97 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 10 643 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 2 993", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve të reja me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 15 raste, komuna Gjilan 9 raste, komuna Podujevë 7 raste, komuna Gjakovë 6 raste, komuna Kamenicë 5 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Viti 5 raste, komuna Deçan 4 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Istog 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Kaçanik 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Mitrovicë, Skenderaj dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja.

### Situata pandemike Covid-19 në Kosovë, e menaxhueshme

Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, ka thënë se situata me pandeminë në Kosovë është e menaxhueshme. Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se ende ka rrezik nga Covidi, duke shtuar se MSh-ja shumë shpejt do të dalë me udhëzues se ku duhet të bartet maska e ku jo. "Kemi rënie të numrit të rasteve ditët e fundit, por nuk guxojmë të kemi rikthim të mosdisiplinës. Kërkojmë rritje të përgjegjësisë dhe të ecim lirshëm drejt vjeshtës. Ministria e Shëndetësisë së shpejti do të ofrojë një udhëzues se ku duhet të bartet maskat e ku jo", ka thënë Zemaj.

Më tutje, ai ka theksuar se këtë udhëzues do ta përgatisin edhe në gjuhën e personave me nevoja të veçanta. "Si Ministri e Shëndetësisë duhet të zotohemi që prezantimin e të dhënave për Covid-19 do ta bëjmë edhe në gjuhën e personave që janë me aftësi të kufizuara. Kërkoj falje në emrin tim dhe të kolegëve të mi, por herëve të tjera do të jemi më të kujdesshëm", është shprehur Zemaj.

## MSh-ja aprovon edhe pesë udhërrëfyes të tjerë klinikë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka nënshkruar sot pesë udhërrëfyes klinikë, pasi të njëjtët janë hartuar nga grupet punuese përkatëse (ekspertë të lëmenjve), janë vlerësuar nga këshilli vlerësues dhe rekomanduar nga Këshilli Kombëtar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike (KKUPK), pas kalimit të të gjitha fazave të parapara me legjislacionin aktual në fuqi (UA 03/2019 për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike). Udhërrëfyesit e aprovuar dhe nënshkruar nga ministri Zemaj janë: Menaxhimi i gjakderdhjeve akute të traktit të sipërm gastrointestinal te të rriturit; Diagnoza dhe manaxhimi i epilepsisë; Përdorimi i metadonit për trajtim mbajtës zëvendësues me opoide; Trajtimi dhe mbikëqyrja e rasteve me HIV/AIDS; dhe Trajtimi me dializë i të rriturve. Udhërrëfyesit e aprovuar do t'u shërbejnë profesionistëve shëndetësorë të të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor (publik dhe privat) për një menaxhim më të lehtë dhe më të saktë të rasteve nga patologjitë në fjalë.

# Dumoshi viziton trajnimet në Prishtinë e Suharekë për aftësimin e të rinjve për tregun e punës



Prishtinë, 7 shtator (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, e shoqëruar nga zëvendësministrja Valdete Bajrami dhe Engelbert Zefaj, ka vëzhguar nga afër dy trajnime për të rinj të cilat po mbahen në kuadër të mbështetjes që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit po bën për fushën e ndërmarrësisë për të rinj.

Organizata BSC Kosovo ka mbajtur trajnime nga fusha e ndërmarrësisë dhe marketingut digjital për të rinjtë e Prishtinës, të Podujevës dhe të Fushë-Kosovës.

Të hënën ministrja Dumoshi bashkë me zëvendësministren Bajrami kanë vizituar Suharekën, gjegjësisht trajnimet për të rinj të organizuara nga organizata Ichat me të rinjtë e Suharekës. Këto trajnime me të rinj nëpër komuna do të ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve dhe në ngritjen e aftësive përmes trajnimeve atraktive e informative.

Ministrja Dumoshi u shpreh tepër e lumtur që përmes mekanizmave të MKRS-së kanë mundur të ndihmojnë kaq shumë të rinj duke i kontribuar rritjes së aftësive të të rinjve të cilat në vijim ata mund t'i përdorin për t'u kyçur në tregun e punës.

Bashkë me kryetarin e Suharekës, Bali Muharremaj, ministrja Dumoshi, zëvendësministrja Bajrami dhe stafi i MKRS-së kanë bërë homazhe edhe në parkun e dëshmorëve në Suharekë. MKRS-ja ka njoftuar se do të jetë pranë të rinjve edhe të komunave të tjera me trajnime të ngjashme.

# 67 për qind e kaluan testin e maturës në afatin e parë

Sipas Komisionit Shtetëror të Maturës (KShM), 67.38 për qind është kalueshmëria në mësimin në gjuhën shqipe, 77.32 për qind në gjuhën boshnjake dhe 62.44 në gjuhën turke. Kryetari i KShM-së, Gëzim Berisha, e ka vlerësuar të suksesshëm administrimin e testit, i cili këtë vit është organizuar në rrethana pandemie

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM) ka bërë publike të hënën rezultatet e Provimit të Maturës Shtetërore 2020 (afati i parë), sipas të cilave, rezultati i përgjithshëm i kalueshmërisë është 67.44 për qind. Prej këtij rezultati, 67.38 për qind është kalueshmëria në mësimin në gjuhën shqipe, 77.32 për qind në gjuhën boshnjake dhe 62.44 në gjuhën turke.

Në test kanë marrë pjesë 25 362 nxënës, nga 26 699 që e kanë



paraqitur testin, prej të cilëve 17 105 e kanë kaluar testin, ndërsa për 8 257 maturantë do të mbetet si mundësi edhe afati i dytë i Provimit të Maturës.

Kryetari i KShM-së, Gëzim Berisha, e ka vlerësuar të suksesshëm administrimin e testit, i cili këtë vit është organizuar në rrethana pandemie, për të cilën gjë i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në proces, ndërsa ka thënë se rezultatet e nxënësve janë të kënaqshme.

Berisha ka bërë me dije se janë 63 maturantë të cilëve u është anuluar testi për shkak se kanë tentuar ta përdorin telefonin, ndërsa nuk ka pasur parregullsi që do ta dëmtonin procesin.

KShM ka bërë me dije se të gjithë ata maturantë të cilët konsiderojnë se iu është bërë ndonjë e padrejtë me rastin e vlerësimit, afati i ankesës është tri ditë dhe kjo e drejtë ushtrohet në shkolla, respektivisht në drejtoritë komunale të arsimit.

# PDK-ja kërkon seancë të jashtëzakonshme për dialogun Kosovë - Serbi




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i konsideron zhgënjyese zhvillimet e fundit në dialogun Kosovë - Serbi. "Pritjet e mëdha qytetare dhe të PDK-së për një marrëveshje finale që garanton njohjen e ndërsjellë janë kthyer në një proces pa afat dhe me kompromise nga delegacioni shtetëror i Kosovës", është thënë në reagimin e PDK-së.

Ky subjekt politik ka theksuar se në takimin e përbashkët të kryesisë dhe grupit parlamentar të PDK-së është konstatuar e rrezikshme rrëshqitja e delegacionit shtetëror nga bisedimet për marrëveshje finale e të obligueshme ligjore, në biseda për tema me karakter teknik. "PDK-ja kërkon nga delegacioni shtetëror i Kosovës që të respektohet Kushtetuta e vendit. Bisedimet për territore dhe pasurinë kombëtare të Kosovës janë anti-kushtetuese dhe kundër interesave strategjike të vendit. PDK-ja e konsideron të padobishëm procesin e Mini-Shengenit të pranuar nga delegacioni shtetëror i Kosovës. PDK-ja është për Shengen, por jo për Mini-Shengen", është theksuar në këtë reagim.

PDK-ja ka përshëndetur paralajmërimin e kryeministrit të Izraelit, Benjamin Natanyahu, për njohjen e Kosovës nga shteti i tij. "Roli i presidentit Trump në këtë proces ishte i jashtëzakonshëm. Kjo i kontribuon hapjes së një kapitulli të ri mes dy vendeve tona. Me qëllim të transparencës më të madhe dhe dhënies së llogarisë para Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve, PDK-ja do të kërkojë seancë të jashtëzakonshme në ditët e ardhshme. Ftojmë të gjitha partitë politike t'i bashkohen kësaj iniciative të domosdoshme", është thënë në këtë reagim të PDK-së.

# Sigurohet strehim i përkohshëm për familjet e kthyera të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve

PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Përmes UNHCR-së, në vitin 2017, 75 familje rome, ashkali dhe egjiptiane u kthyen në Kosovë nga Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi. Fatkeqësisht, shumica e këtyre familjeve nuk e kanë zgjidhur ende përgjithmonë çështjen e tyre të strehimit dhe jetojnë në kushte shumë të vështira dhe çnjerëzore. Arsyet për këtë janë më së shpeshti mungesa e tokës në pronësi të këtyre familjeve, gjendja e keqe ekonomike, papunësia, pengesat procedurale në lidhje me ndërtimin e shtëpive dhe të tjera.

Për shkak të borxheve të prapambetura të qirasë dhe faturave të papaguara të shërbimeve, ekzistonte rreziku që 49 familje të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të mbeteshin pa çatinë e tyre të përkohshme mbi kokë. "Fatkeqësisht, komunat në të cilat familjet e përmendura me gjithsej 194 anëtarë kanë gjetur strehim të përkohshëm nuk kanë qenë në gjendje të ndihmojnë në mënyrë të konsiderueshme me zgjidhje të përhershme. Pandemia e virusit 'Korona' ka përkeqësuar më tej situatën tashmë të dobët ekonomike dhe mundësinë e punësimit sezonal për shumë anëtarë të këtyre familjeve. Hedhja e tyre në rrugë do të shkaktonte një katastrofë të vërtetë humanitare në kohën e krizave të një pandemie",



thuhet në njoftimin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Bëhet me dije se me iniciativën e ministrit Dalibor Jevtiq, përkundër shkurtimeve të mëdha të buxhetit, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka mbuluar shpenzimet e qirasë dhe të shërbimeve në vitin 2020 për 49 familje të kthyera të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, të cilët gjetën strehim të përkohshëm në komunat e Prizrenit, Ferizaj, Obiliq, Graçanicë, Dragash, Pejë dhe Gjilan.

Ministria për Komunitete dhe Kthim ka informuar autoritetet e përmendura komunale për këtë dhe në të njëjtën kohë u ka bërë apel atyre që t'i përfshijnë këto familje të rrezikuara në skemat e kujdesit shoqëror në përputhje me ligjet në fuqi në vitet e ardhshme.

Pagesa e qirasë për familjet e kthyera të rrezikuara të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve u realizua përmes Këshillit danez për Refugjatë.

# Kryetarja e Kuvendit pranon raportin vjetor të auditimit për vitin 2019



PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Auditori i përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), Besnik Osmani, i ka dorëzuar kryetares së Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu, Raportin vjetor të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019.

Osmani është pritur në takim të veçantë nga kryetarja e Kuvendit dhe me këtë rast, e ka informuar atë për përmbylljen me sukses të vitit auditues, si dhe për sfidat, të cilat e kanë shoqëruar procesin, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia. "Ka qenë sfidues balancimi i nevojave për ruajtjen e shëndetit të auditorëve dhe paralelisht zbatimi i mandatit, duke siguruar cilësinë e punës sonë por, përkundër vështirësive, kemi arritur që me kohë ta dorëzojmë Raportin e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Republikës të Kosovës për vitin 2019, duke e përmbyllur me sukses të plotë vitin auditues", ka deklaruar Osmani.

Ndër të tjera, auditori i përgjithshëm ka theksuar se fokusi parësor i punës së ZKA-së kanë qenë vlerësimet për cilësinë e raportimit financiar, dizajnimin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Përmes procesit të auditimit është konstatuar se ka një përparim të lehtë në fushën e raportimit financiar, por mangësitë dhe dobësitë më të theksuara vazhdojnë të mbeten në aktivitetet ekzekutive të buxhetit, ku shumë projekte kapitale fillohen pa fonde të mjaftueshme dhe, për shkak të kësaj, ato rrallëherë përfundohen me kohë, ndërkohë që mbikëqyrja nuk parandalon devijimet e shumta nga kushtet e përcaktuara me kontrata. Me këtë rast në mënyrë të veçantë është kërkuar nga qeveria që ta forcojë disiplinën financiare, sepse shumat e detyrimeve të papaguara dhe llogarive të arkëtueshme kanë arritur shifra të larta dhe padyshim janë sfidat kryesore të qeverisë derisa regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive paraqesin një problem të përsëritur prej shumë vitesh dhe përparimi në këtë fushë është i varfër, është shprehur auditori i përgjithshëm. Gjatë vitit raportues janë audituar 95 organizata buxhetore me një buxhet të përgjithshëm rreth 2.5 miliardë, 14 ndërmarrje publike kryesisht në fushën e telekomunikimit, furnizimit me ujë dhe trajtimit të mbeturinave, 13 auditime të performancës si dhe 9 projekte të financuara nga fondet e donatorëve. Zyra Kombëtare e Auditimit më 15 shtator fillon vitin e ri të auditimit dhe aktualisht në mënyrë intensive po punohet në planin vjetor të punës 2020/2021.

# Punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit kërcënojnë me protestë nëse nuk i marrin 300 euro shtesë



PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Sektorit Privat ka paralajmëruar se punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit do të mbajnë një grevë njëorëshe të premten për shkak të mospërfshirjes së tyre në masën stimuluese prej 300 eurosh sikurse punëtorët shëndetësorë.

Nëse kërkesa për përfshirje të tyre në këtë masë nuk merret parasysh, kryetari i Sindikatës, Jusuf Azemi, ka thënë se veprimet e tyre sindikale do t'i radikalizojnë. "Në këtë javë do t'i fillojmë protestat, ndoshta edhe me veprime të tjera pas kërkesave që ua kemi bërë kryeministrit, ministrit të Financave, ministrit të Shëndetësisë. Kemi bërë kërkesë që edhe punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit duhet të stimulohen me shtesën 300 euro, ashtu siç stimulohen edhe mjekët", ka theksuar Azemi. Ai ka thënë se nga ora 13:00 deri në orën 14:00 të premten këta punëtorë nuk do të kryejnë shërbime në qendrat spitalore, në qendrat e mjekësive familjare dhe në ambulanca.

## Mbahet ankandi i njëmbëdhjetë për shitjen e letrave me vlerë



PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Ministria e Financave ka njoftuar se më 14 shtator do të mbahet ankandi i njëmbëdhjetë i letrave me vlerë për vitin 2020. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet pesëvjeçar në shumën prej 25 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu u garantohet të gjithëve për kohëzgjatjen (5 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave, duke shtuar se për hollësi rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëra nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.

# Ambasadori gjerman thotë se është i interesuar ta çojë përpara zhvillimin ekonomik të Kosovës



PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e ri gjerman në Kosovë, Jorn Rohde. Bashkë me ambasadorin gjerman ishin edhe zëvendësi i tij, Jan-Axel Voss dhe drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Nora Hasani. Mes ambasadorit Rohde dhe ministrit Kuçi u diskutua për disa tema, përfshirë edhe marrëveshjet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë edhe marrëveshjen e fundit në Uashington, për të cilën ministri Kuçi ka theksuar se po presin kthimin e ekipit të Kosovës për ta krijuar planin e menaxhimit të pikave të marrëveshjes. Rëndësia e Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren, projekt për të cilin Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka ndarë edhe buxhet, u konstatua se do të ecë përpara me hapa të shpejtë, pasi interesimi për të zhvilluar veprimtari në këtë park është i madh.

Temë e takimit ishte edhe energjia, që ka marrë një fokus dhe përkrahje më të madhe nga MEA, ku tashmë nga gjermanët po bëhen edhe studime për ta parë saktë zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme për ta nxitur plotësimin e kuotës për këtë energji.

Ambasadori Rohde ka potencuar se në mandatin e tij si ambasador është i interesuar ta çojë përpara zhvillimin ekonomik nëpërmjet rritjes së eksportit të produkteve të Kosovës drejt Gjermanisë, gjithashtu duke i kanalizuar remitencat milionëshe që vijnë nga ky vend. Për këtë ministri Kuçi i ofroi mbështetje të plotë.

Ministri Blerim Kuçi dhe ambasadori Jorn Rohde ishin të pajtimit edhe për strategjitë për investime dhe ndihmë kur bëhet fjalë përshtatjen me programet e rimëkëmbjes ekonomike nga Covid-19.

# OAK-u kërkon që të largohet kufizimi i orarit dhe të lejohet puna brenda restoranteve

PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - "Gjendja e rëndë e sektorit privat si rezultat i pandemisë dhe mospërkrahja e mjaftueshme e bizneseve dhe punëtorëve të sektorit privat nga ana e qeverisë është arsyeja që kërkohet nga qeveria që menjëherë të largohen kufizimet e orarit dhe të lejohet puna e restoranteve brenda", thuhet në kërkesën që Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) e ka dërguar tek kryeministri i Kosovës.




Sipas OAK-ut, mosfunksionimi i bizneseve, në veçanti i sektorit të gastronomisë, gjatë periudhës së pandemisë si dhe vendimet për kufizim të orareve të punës, kufizim që, përveç se po ndikon në dëmtim të bizneseve, po ndikon negativisht edhe në ekonominë vendore. "Ky vendim është marrë me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë, mirëpo duke parë lëvizjet e shumta që qytetarët e Republikës së Kosovës po bëjnë jashtë vendit për ta vizituar bregdetin dhe masat e pakta që janë në këto vende, Oda e Afarizmit të Kosovës kërkon që të lejohet funksionimi normal i bizneseve të gastronomisë dhe ky vendim të anulohet. OAK konsideron që për ndryshim të këtij vendimi duhet të merren masa për kontrollim dhe respektim të rregulloreve për funksionimin e këtyre bizneseve", thuhet në komunikatën e OAK-ut.

## "Shell"-i dhuron 27 laptopë për Shkollën Fillore "Faik Konica"

PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Duke parë problemet e vazhdueshme të cilat po shkaktohen në proceset mësimore si rezultat i Covid-19 dhe pas kërkesës nga kryetari i këshillit drejtues i Shkollës Fillore "Faik Konica", Kushtrim Demiri, "Shell Kosova" iu ka bashkangjitur iniciativës për të dhuruar donacion 27 laptopë nga një për secilën klasë. Nëpërmjet kësaj iniciative "Shell Kosova" ka ndier obligim që t'i ndihmojë mësimdhënësit e Shkollës Fillore "Faik Konica" në Prishtinë dhe t'ua lehtësojë zhvillimin e mësimit edhe në formë virtuale.

Iniciativat për donacione nuk kanë munguar as në të kaluarën nga "Shell Kosova", ku gjithmonë kanë qenë të gatshëm për të kontribuar në projekte të ndryshme me karakter lehtësimi dhe zhvillimi për shoqërinë tonë drejt shtegtimit të tyre për sukses.



# Ministri Likaj dhe kryetari i SBAShK-ut vizituan disa shkolla në Obiliq

OBILIQ, 7 SHTATOR (ER) - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, kanë vizituar Gjimnazin "17 Shkurti", Shkollën e Mesme Profesionale "Ismajl Dumoshi" në Obiliq dhe Shkollën e Mesme të Ulët "Hasan Prishtina" në fshatin Milloshevë.
Të shoqëruar nga kryetarja e nivelit komunal sindikal, Luljejta Boshnjaku dhe drejtori i DKA-së, Rexhep Zeka, ata kanë parë nga afër përgatitjet e bëra dhe angazhimin e vazhdueshëm të të punësuarve në këto institucione arsimore për t'u përgatitur sa më shumë për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor më 14 shtator.
Drejtorët dhe të punësuarit e tjerë në këto shkolla kanë shprehur gatishmërinë për ta nisur mbarë vitin shkollor, kurse drejtori i DKA-së ka lavdëruar për bashkëpunim MASh-in e SBAShK-un dhe ka deklaruar se gjatë këtyre ditëve të mbetura do të finalizohen përgatitjet për ta nisur mbarë vitin e ri shkollor.
Ministri i MASh-it, Ramë Likaj dhe kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, kanë vizituar edhe Kuvendin Komunal dhe kanë bashkëbiseduar për arsimin në këtë komunë me nënkryetarin Ibush Mjekiqi. Ata janë shprehur se këto vizita të përbashkëta në institucionet arsimore janë dëshmi e bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët në shërbim të arsimit. Likaj dhe Jasharaj edhe në ditët në vazhdim do t'i vizitojnë institucionet arsimore në komunat e tjera të Kosovës.



# Aliu u ndan mirënjohje deputetëve ferizajas të Kushtetutës së Kaçanikut



FERIZAJ, 7 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka ndarë mirënjohje për ish-deputetët e kësaj komune që më 7 shtator 1990 mbrojtën themelet e shtetësisë, Kushtetutës së Kaçanikut. "Sot, 30 vjet më parë, nuk ishte aspak e lehtë ta artikulosh pavarësinë e t'i ndërtosh themelet e Kushtetutës së Kosovës, Kuvend i cili u mbajt në Kaçanikun e legjendave e gjurmëve të lashta të historisë më 7 shtator 1990. Ferizaj pati deputetët Ali Shahini, Binaze Jashari, Shaban Hashani, Muhamet Shabani, Nazmi Fejzullahu e Ismajl Sahiti, që me guxim qytetar dhe politik, sypatrembur, mbrojtën themelet e shtetësisë në ngjizje të Kosovës", ka thënë kryetari Aliu, duke shtuar se: "Në këtë jubile të 30-të nderova me mirënjohje institucionale këta burra e gra që në pikun e vlimeve për komb e atdhe u rreshtuan guximshëm në anën e drejtë të historisë".

# Gjilani nis fazën e katërt të dezinsektimit hapësinor

GJILAN, 7 SHTATOR (ER) - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Gjilanit ka njoftuar se ka nisur faza e katërt e dezinsektimit hapësinor me qëllim të eliminimit të insekteve që në ditët e fundit ka një shtim të madh të tyre.
Selami Xhemajli, drejtor i DSHMS-së, ka potencuar se, përkundër që në vitet e tjera efekti është arritur në tri faza të dezinsektimit, këtë vit gjendja është ndryshe dhe në bazë të vlerësimit që ka dhënë komisioni komunal dhe ekspertët e fushës, është i domosdoshëm edhe intervenimi me fazën e katërt. "Pas ankesave të shumta që kanë ardhur nga qytetarët e Gjilanit, për prani të shtuar të insekteve, veçanërisht të mushkonjave, do ta fillojmë fazën e katërt të dezinsektimit hapësinor, nga sonte në orën 19:00 deri në orën 24:00, deri në përmbylljen e plotë sipas planit. Fillimisht do të bëhet dezinsektimi në qytet dhe do të vazhdohet gjatë ditës së nesërme e tutje edhe nëpër fshatra. Apelojmë te bletarët që në këtë interval kohor deri në fund të javës t'i mbajnë të mbyllura bletët, për të mos i dëmtuar ato", ka thënë Xhemajli.



# Drejtorët komunalë në Malishevë raportojnë për punët e tyre para kryetarit Begaj

MALISHEVË, 7 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka drejtuar mbledhjen e rregullt të këshillit të drejtorëve, në të cilën ka kërkuar raportim nga secili drejtor për punët e kryera, projektet të cilat janë në vazhdim si dhe të procedohet me projektet të reja të cilat janë të planifikuara.
Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ka njoftuar se nga 7 shtatori ka filluar procesin e punës Çerdhja "Zërat e Ëmbël" në Malishevë, pasi tërë punëtorët kanë rezultuar negativë pas testit të bërë për Covid-19. Ai në këtë mbledhje ka raportuar se janë përgatitur me tekste shkollore, maska dhe dezinfektues edhe për fillim të mësimit në institucionet publike shkollore si dhe për së cilin variant që mund të paraqitet në vijim të procesit mësimor.
Nga Inspektorati, drejtori Dibran Kastrati ka thënë se janë në inspektim të vazhdueshëm të të gjitha lokaleve biznesore. "Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse do ta mbikëqyrim zbatimin e masave anti Covid se si po zbatohen. Kjo punë do të vazhdojë edhe në ditët në vazhdim", ka thënë ai.




Drejtoresha e Administratës, Besarta Kryeziu-Ramaj, ka raportuar se ka bërë furnizimin me materiale të zyrave në tërë administratën.
Valon Mazreku nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka theksuar se janë duke punuar rreth përgatitjes për buxhetin e viti 2021 në mënyrë që të jenë në linjë kohore me afatin ligjor. Ndërsa drejtori i Urbanizimit, Ahmet Morina, ka thënë se planifikimet e parapara të projekteve në rrugë, ndriçim, kanalizime, në sektorin e sportit dhe shumë projekte të tjera, janë duke u realizuar.
Në këtë mbledhje kanë raportuar edhe drejtor i DKRS-së, Rexhep Mazreku, Hafir Rexha nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Liridon Hoti nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Bashkim Krasniqi nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

# A MUND TË JETË KOMANDANT I UÇK-së AI QË E QUAJTI ORGANIZATË TERRORISTE?!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Shtrembërim i së vërtetës përmes protagonizmit virtual:** Gjatë luftës madhështore të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, në krye me Komandantin Politik, Bacën e Madh Adem Demaçi dhe Komandantin Ushtarak, Komandantin Legjendar Adem Jashari, shqiptarët, për herë të parë në histori e bënë luftën për vete, për liri, për çlirim dhe për bashkim kombëtar. Gjatë përpjekjeve për çlirim, shqiptarët e papërgatitur ushtarakisht, të vogël në numër, pa aleatë dhe në kushte të robërimit permanent, gjithmonë kanë qenë nën flamur të shteteve të tjera dhe, përmes tyre, janë munduar t'i realizojnë aspiratat shekullore. I kanë shërbyer Perandorisë Romake, asaj Bizantine, Perandorisë Osmane, nja 300 vjet bullgarëve, mbi 100 vjet serbëve, turqve, italianëve dhe gjermanëve. Pikërisht këta që iu kanë shërbyer serbëve kanë qenë kundër lirisë të shqiptarëve e sidomos kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilën e kanë sulmuar dhe luftuar çdoherë kur iu ipej rasti. Frymën liridashëse dhe zjarrin e luftës për liri, të trashëguar nga rezistenca shekullore e ruajtën, mbrojtën dhe mbajtën gjallë të gjithë ata që sakrifikuan çdo gjë që patën për popullin dhe lirinë. Ishte Hasan Prishtina, truri, mendja dhe shpirti i lëvizjes shqiptare për liri dhe bashkim kombëtar. Isa Boletini ishte pjesëmarrës dhe udhëheqës i të gjitha betejave shqiptare për liri duke e vendosur një xhevahir në Kurorën e Pavarësisë në Vlorë. Pabesisht u ekzekutua në një pritë në Mal të Zi, së bashku me shumë familjarë, nga gjyshi i komunistit Milovan Gjilas që ishte edhe vetë pjesë e persekutimit të shqiptarëve para, gjatë dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në ish-Jugosllavi. Azem Bejta dhe Shotë Galica, Ahmet Delija dhe Ukshin Kovaçica, Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica, Shyt Mareci dhe Hoxhë Idriz Gjilani, Gjon Serreqi dhe Marie Shllaku, Jahja Fusha dhe Bec Bajçinoci, Fazli Grejçevci dhe Shaban Shala, Tahir dhe Nebih Meha, Ukshin Hoti, Nuhi Berisha dhe Rexhep Mala, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Agim Ramadani dhe Sali Çekaj si dhe të gjithë heronjtë që e dhanë jetën për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar e që numri i tyre është i madh. Epiqendra e luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar ishte Drenica, prandaj Prekazi është kryeqytet i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Dukagjini bëri luftë të jashtëzakonshme sikur që as Llapi nuk e ndali luftën asnjëherë sikur edhe Karadaku. Kontribut të madh dhanë ish të burgosurit politikë shqiptarë, që pshurrën dhe dhjenë gjak nga torturat e paraardhësve të këtyre që ishin kundër UÇK-së e që edhe sot bëjnë përpjekje të marrin merita, ndonëse mendimin e kishin kriminal, kurse veprimin edhe më kriminal. Kthesa e madhe dhe vendimtare u bë me paraqitjen e Ushtrisë së Lavdishme Çlirimtare të Kosovës e udhëhequr nga komandantët, Baca Adem Demaçi dhe Komandanti Legjendar Adem Jashari. Dihet fort mirë qëndrimi i politikanëve të atëhershëm shqiptarë, në Kosovë si dhe në Shqipëri për luftën e UÇK-së, kush e ndihmoi dhe kush e sabotoi atë. Në atë periudhë dy persona e kanë cilësuar UÇK-në terroriste: Ibrahim Rugova që ishte president i një shteti që nuk e kishte pranuar askush e që ishte plotësisht i robëruar nga regjimi jugosllav që ishte nën urdhrat e regjimit serb dhe Gelbart, që ishte personalitet që angazhohej për një autonomi brenda Serbisë, por që pazarin ua prishi lufta e UÇK-së. Në atë kohë i vetmi personalitet që e kundërshtoi Gelbardin ishte i Pavdekshmi Bacë Adem Demaçi, kurse të tjerët që pretendonin se merreshin me politikë, në Kosovë dhe Shqipëri, ia mbanin zhagun Gelbardit. Thuhej se po t'ua zhvishnin pantallonat ushtarëve të UÇK-së do të shihnin se nuk ishin bërë synet duke i identifikuar me serbë që e flasin mirë gjuhën shqipe. Gjithashtu, ishte fshehtësi publike se pikërisht krerët e LDK-së së atëhershme filluan një fushatë denigruese kundër ish të burgosurve politikë shqiptarë duke i konsideruar më të rrezikshëm (për LDK-në) se vetë Serbia. Kjo kishte ndodhur në disa mbledhje të degës së LDK-së në Besianë!

**Po a kemi reaguar mirë ne, ish të burgosurit politikë:** Baca Adem, sa ishim në llogorin e Stara Gradishkës kishte përkrahje pa asnjë rezervë për Ibrahim Rugovën dhe, ndonëse kishte popullaritet të jashtëzakonshëm, nuk deshi ta rivalizonte, pas daljes nga burgu. Po në këtë frymë na udhëzoi edhe ne që ta përkrahnim Ibrahim Rugovën e që pjesa më e madhe edhe e bëri duke votuar në zgjedhjet e para pikërisht për Rugovën. Me këtë Baca Adem e shmangu një çarje të madhe brendashqiptare. Baca Adem ishte kundër çdo hakmarrjeje, prandaj të burgosurit politikë shqiptarë u sillën me urtësi dhe butësi ndaj ish atyre që i keqtrajtuan, deri në vdekje, politikisht dhe fizikisht. Nëse shihet në retrospektivë mbase kemi gabuar që nuk kërkuam, e kemi mundur shumë lehtë, përgjegjësi nga persekutuesit tanë mirëpo, nëse kemi parasysh interesin kombëtar, Baca Adem kishte të drejtë. Me "nënshtrimin" tonë ndaj atyre që na nënshtruan, e evituam një luftë vëllavrasëse (ndonëse nuk ishin vëllezër tanë në asnjë aspekt), e eliminuam përçarjen e madhe. Këta, në vend se të ndiejnë një brejtje ndërgjegjeje, së bashku me ndërkombëtarët, ish-hetuesit, ish-prokurorët, ish-gjykatësit dhe me individë të kriminalizuar që kishin luftuar në Padesh dhe Kukës për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, sajonin dosje duke e vazhduar persekutimin, tash me mjete të tjera. Më së paku që është dashur të bëjnë ish të burgosurit politikë shqiptarë ka qenë të kërkojmë të hapen dosjet tona ose t'i dorëzojmë aktakuzat dhe aktgjykimet në Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë (po të ishte shoqatë si duhet e jo një shoqatë oportuniste dhe klienteliste) dhe nuk e kemi bërë këtë. Kështu, u krijua një hapësirë për rikthim dhe sistemim në të gjitha nivelet në Kosovë e atyre, ose të pasardhësve të tyre biologjikë dhe politikë për të kalëruar sërish mbi vuajtjet dhe persekutimin tonë. Po të kishim një Shoqatë për të Burgosur Politikë që mbron të gjithë ish të burgosurit politikë, pa bërë asnjë dallim, sot do ta kishim një gjendje tjetër në Kosovë. Asnjë proces apo vendim nuk do të zhvillohej apo të merrej në kundërshtim me interesat kombëtare dhe shtetërore. Po, për shkak të klientelizmit, ish të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë nuk paraqesin asnjë fuqi dhe kemi mbetur vetëm të takohemi në varrime të shokëve dhe bashkëvuajtësve. Një numër i vogël u shkri në karrierën korruptive politike, kurse pjesa më e madhe mbeti kategori sociale. E dhimbshme, por e vërtetë.




**A ishin Ibrahim Rugova komandant i UÇK-së dhe Fatmir Sejdiu komisar politik i UÇK-së:** Fatmir Sejdiu, që ka një përvojë të gjatë politike, që nga koha e Titos e deri më sot, në një intervistë deklaroi se Ibrahim Rugova me Kushtetutë paska qenë komandant suprem i forcave të armatosura të Taxhikistanit sepse realisht në Kosovë nuk e ka pranuar UÇK-në, madje e ka quajtur terroriste, sikur të ishte vëlla i Gelbardit. Tash Fatmiri po thotë, me gojën plotë se Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti paskan qenë ushtarë të Ibrahim Rugovës dhe se listat për ushtrime ushtarake në Shqipëri i paska bërë LDK-ja. Deklaratë e denjë për datën 1 prill, Ditën Ndërkombëtare e Bishtërimit të së Vërtetës. Edhe unë, së bashku me gruan time Fexhrije Shala kam qenë në listë për ushtrime në Shqipëri por se këtë listë nuk e ka bërë as "komandanti" Ibrahim Rugova apo "komisari politik" Fatmir Sejdiu por se e ka bërë Patrioti i Madh i Çështjes Kombëtare, Ahmet Haxhiu. Kjo listë dështoi për faktin se pati shumë arrestime në atë kohë, kryesisht të veprimtarëve të LPK-së. Asnjëherë nuk kam thënë se Ibrahim Rugova ka qenë njeri apo shqiptar i keq por gjithmonë kam thënë dhe e them se atij, si intelektual dhe si të gjithë intelektualëve të kohës së Titos, i ka munguar guximi të marrë përgjegjësi për diçka që ia rrezikon jetën. Intelektualët kurrë nuk e kanë bërë luftën por i kanë zhvatur rezultatet e luftës, qoftë materialisht apo përmes ndërtimit të karrierës politike. Sa për Ibrahim Rugovën e Fatmir Sejdiun në Kosovë në 1000 vjetët e ardhshëm nuk do të kishte luftë por e vërteta është se luftën e organizuan dhe e bënë LPK, LKÇK, ish të burgosurit politikë shqiptarë, ata që kurrë nuk u pajtuan me robërinë dhe e luftuan në të gjitha regjimet (Drenica, Dukagjini, Llapi, Karadaku etj.). Luftuan edhe anëtarë të LDK-së që ishin patriotë të vërtetë kurse këta që i përmend Fatmir Sejdiu, si alfa dhe omega e UÇK-së organizonin vizita në terren dhe kërkonin dorëzimin e armëve sikur edhe ndërprerjen e luftës së armatosur. Po të ishte ashtu siç thotë Fatmir Sejdiu, Gjykatat për Krime Lufte që gjykojnë dhe dënojnë sipas përgjegjësisë komanduese, politike dhe ushtarake filluar nga Tribunali i Hagës, Ibrahim Rugovën do ta ftonin si të akuzuar si dhe Fatmir Sejdiun. E kjo Gjykata Speciale, po të ishte gjallë Ibrahim Rugova, në vend të Agim Çekut, si komandant të UÇK-së do ta ftonte Rugovën e në vend të Hashim Thaçit, si drejtor politik, do ta ftonte Fatmir Sejdiun, komisar politik, si të dyshuar, natyrisht. Edhe për vrasjet e pasqaruara pas luftës, si të anëtarëve të LDK-së por edhe të UÇK-së, Fatmiri fajëson gjykatat ndonëse LDK-ja, që nga përfundimi i luftës kishte ministër të Drejtësisë apo të Punëve të Brendshme dhe as që e ka lëvizur prapanicën për ndriçim të këtyre rasteve përveç se i ka keqpërdorur për qëllime elektorale, marrje të pushtetit dhe mbajtje të pushtetit. Në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtat qëllime kanë manipuluar dhe po manipulojnë me emrin e Ibrahim Rugovës. Keqbërës kanë qenë, keqbërës kanë mbetur. Të tillë sot edhe po e vendosin për fatin e Kosovës! Të politikës "paqësore" si dhe ata të luftës, pa asnjë dallim. Janë bërë një!

# KRIZA JONË E LEXIMIT

"Në libra ka më shumë thesar sesa pre piratësh në Ishullin e Thesarit ... dhe më e mira nga të gjitha, ju mund ta shijoni atë pasuri çdo ditë të jetës suaj" / *Walt Disney*



**Lulëzim ETEMAJ**

Nuk mund të jetë ndryshe pozicioni i librit në një shoqëri të caktuar të një vendi, nëse leximi është në krizë. Janë faktorë të shumtë që e determinojnë krizën e leximit. Faktori social, faktori kulturor dhe ai ekonomik, janë disa prej tyre. Është interesant se si temë, për aq sa unë kam informacione, kriza e leximit nuk ka paraqitur deri më tani ndonjë prioritet për studim serioz as nga persona të fushave të caktuara profesionale dhe as nga ndonjë institucion relevant. Prandaj, përveç ndonjë ankese ditore, të publikuar në media të shtypura, elektronike apo sociale, mungojnë studimet shkencore. Në mungesë të tyre, mungojnë edhe projektet dhe strategjitë se si të përmirësohet kjo gjendje.

Për t'iu shmangur konstatimit ekstrem unë kam mendimin se një shoqëri, ku leximi, më i miri ushqim për trurin, është në krizë, i ekspozohet rrezikut të stërkeqjes dhe huqjes së zhvillimit të shëndetshëm.

Në një situatë të tillë është çështje kohe se sa mund të qëndrojnë në këmbë, të kenë vullnetin për të shkruar dhe botuar edhe më tej krijuesit, njerëzit e letrave, siç i quajmë herë pas here.

Demotivim shtesë për ta është edhe qëndrimi i librarive dhe trajtimi që ata e gëzojnë prej tyre. Pjesa dërrmuese e librarive, jo vetëm në kryeqytet, Prishtinë, krahas taksës deri në 40 për qind (!!), që e marrin nga shitja e librit, nuk u përgjigjen kurrë krijuesve për t'ua paguar pjesën tjetër të çmimit nga shitja e librit. Dhe, po ndodhi e ua kërkuan, shikohen çuditshëm prej tyre. Vështirë të ketë një krijues të vetëm në Prishtinë që të mos e ketë përjetuar një trajtim të tillë fyes dhe degradues.

Ky është një problem më tepër në kurriz të librit!

Mediat sociale; gjendja socioekonomike; situata politike. Në numërim të shpejtë, këta mund të jenë disa nga faktorët që ndikojnë në krizën e leximit. Porse, kjo është një qasje tepër optimiste. Sepse shqiptarët në kohë edhe më të liga, në çdo drejtim, posaçërisht të rinjtë - nxënësit dhe studentët, janë dalluar si për blerjen ashtu dhe për leximin e librave. Për rrjedhojë shumë prej tyre, në mungesë të zgjidhjeve të tjera, janë bërë anëtarë të rregullt të bibliotekave apo dhe kanë kursyer paratë nga ushqimi për të blerë ndonjë libër, ngritur dhe pasuruar bibliotekat personale.





Kriza e leximit është një problem i yni nacional. Një problem më tepër në radhën e problemeve të shumta të kombit tonë. Kushdo që ka një mendim tjetër, le ta pyes veten, në radhë të parë, pastaj të afërmit dhe miqtë, se cili është libri i fundit që e kanë lexuar. Apo kur kanë qenë për herë të fundit në një bibliotekë, pavarësisht rrethanave pandemike.

Kjo krizë nacionale kërkon qasje dhe trajtim shkencor të përshpejtuar jo vetëm nga ana e sociologëve. Në një gjendje të tillë, vrasja e mëtejme e kohës nga ana e tyre, përgjithësisht njerëzve të shkencës, duke qëndruar në media sociale, si "Facebook", "Twitter", "Instagram" etj., ku veprimtari kryesore e kanë urimin për ditëlindje të fëmijëve, hallave, tezeve, gjyshërve, bashkëshorteve apo bashkëshortëve, është më shumë sesa papërgjegjësi!

Përgjithësisht, si komb, jemi të pamposhtur sa i përket vrasjes së kohës në media sociale. Prandaj, për fat të keq, postimet budallaqe, përfshirë edhe pëlqimet (like-et) symbyllurazi, janë të pandalshme dhe të pafundme.

Leximi, pra librat, jo vetëm që na merr përdore nëpër botë të tjera, por na i bën me krahë edhe ëndrrat dhe hap horizonte të reja për jetësimin e tyre.

Leximi forcon shpirtin! thotë Volteri.

# Regjisorët Ekrem Kryeziu dhe Samir Karahoda fitojnë çmimet për kinematografi

**Prishtinë, 7 shtator (ER)** - Regjisorit dhe dramaturgut Ekrem Kryeziu i ndahet Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu", ndërsa Çmimi Vjetor për Kinematografi i ndahet regjisorit Samir Karahoda.

Ky vendim është marrë nga juria profesionale në përbërje të Arbnesha Grabovci-Nixha kryetare, Burbuqe Berisha, Kimete Berisha, Agron Vula dhe Blerta Basholli, anëtare.

Arsyetimi i jurisë për ndarjen e çmimit kryesor regjisorit Kryeziu është për shkak se ai ka qenë shumë aktiv në zhvillimin e filmit të Kosovës, duke filluar me pavarësimin e autorëve në botën e regjisë nga Televizioni i Prishtinës, ku ka prodhuar dy filma.

Kryeziu ka qenë pjesë e "Kosovafilm"-it që nga themelimi me filmat "Kur pranvera vonohet" dhe "Gjurmë të bardha" dhe ky film ka qenë edhe arsye e burgosjes së tij për vepër artistike.

Regjisori Kryeziu ka krijuar edhe pas mbylljes së institucioneve nga regjimi serb dhe ka kontribuar jashtëzakonisht shumë për kinematografinë e Kosovës.

Ndërkaq vlerësimi i jurisë për regjisorin Karahoda është se ai i takon valës së re të filmbërësve, suksesi i të cilit me filmin "Në mes" për herë të parë vuri emrin e Kosovës në konkurrencën zyrtare të Festivalit të Berlinales, një prej festivaleve më të shquara të Kategorisë A.

Suksesi i filmit "Në mes" numëron një mori suksesesh duke marrë pjesë edhe në shumë festivale të tjera prestigjioze dhe, së fundmi, edhe në konkurrencën zyrtare të Festivalit Ndërkombëtar të Qipros, përkundër pengesave politike, ku në këtë festival ka fituar kandidimin për Çmimin e Filmit të Shkurtër dokumentar në European Film Academy.





Karahoda është nominuar për këtë çmim nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Me këtë rast, ministrja Kulturës, Rinisë dhe Sporti, Vlora Dumoshi, e ka vlerësuar lart vendimin e jurisë dhe ka uruar laureatët.

Ajo ka thënë se këto çmime janë një mirënjohje institucionale për punën që bëjnë njerëzit që merren me kinematografi në vendin tonë, që i kanë sjellë vlera artistike në fushën e filmit duke e pasuruar krijimtarinë.

# Sikur të isha grua

-tregim satirik-



AZIS NESIN

## Shënime për autorin

NESIN, Aziz
Mehmet Nusret Nesin, i njohur si Aziz Nesin, shkrimtar turk, autor i më shumë se 100 librave për fëmijë dhe të rritur. Përveç shkrimtar, ka qenë edhe humorist. Shumë tregime të tij janë botuar në disa përmbledhje në gjuhën shqipe. Ai shkroi me emrin Aziz Nesin, i cili ishte emri i babait të tij, i përdorur nga Nesini si pseudonim.

Selameti u caktua roje porte në një fabrikë endjesh. Do të merrte 80 lira në muaj. Asnjë portier nuk mund të jetojë me 80 lira. As një e katërta e njeriut nuk mund të jetojë me to. Por Selameti mbështetej në zellin e tij për punë. Pronari i tij, në fund të fundit, do ta kuptonte gatishmërinë e tij dhe do t'ia rriste pagën. Sigurisht, puna e portierit ishte e ulët për të po, ç'të bënte! Pa shih, sot njerëzit e kanë humbur ekuilibrin e vet. Sa e sa e bëjnë punën e portierit, ndërsa nuk ia vlejnë as për roje! Selameti kishte arritur deri në vitin e dytë të gjimnazit. Në atë kohë ndodhi një nga dramat më të zakonshme familjare dhe u detyrua ta braktiste shkollën.
Punonte pa llogaritur vuajtje dhe sakrifica, për të marrë atë shtesën e vogël të pagës së vet. Ah, të ishte roje nate! Roja i natës së fabrikës merrte bram në dorë 200 lira në muaj. Dhe punë për qejfin e vet, nuk lodhej.
Kur njeriu dëshiron diçka me gjithë shpirt, dëshira e tij plotësohet. Një ditë të bukur pronari e thirri Selametin në zyrën e vet:
- Jam i kënaqur me ty - i tha.
- Faleminderit, faleminderit!
- Je i martuar ? - e pyet pronari.
- Po - i tha Selameti, duke u rrudhur, sikur ta kishin zënë duke kryer ndonjë krim.
Duke e kuptuar gabimin e vet dhe për ta çliruar pakëz shpirtin e tij, shtoi duke ulur kokën:
- Kam edhe dy fëmijë, bej efendi.
Pronari e mëshiroi dhe psherëtiu:
- E, e... dhe si ia del mbanë?
- Shumë vështirë, bej efendi.
- Hajde, diçka do të bëj edhe për ty. Do t'ia dalësh mbanë ta bësh edhe punën e rojës së portës, edhe atë të rojës së natës?
- Do t'ia dal, bej efendi.
Që të themi të drejtën, vetëm gjashtë orë në ditë rri te porta. Llogarit edhe tetë orë natën, na bëjnë katërmbëdhjetë. Të mbeten edhe dhjetë orë. Në rregull?
- Faleminderit, bej efendi!
- Për punën e natës do të të jap edhe 30 lira në muaj.
- Faleminderit!
Roja i natës, i cili merrte 200 lira në muaj, u pushua menjëherë, se flinte në orarin e punës dhe vendin e tij e mori portieri ynë. Ditën qëndronte tek porta, ndërsa natën ruante fabrikën me orën e kontrollit të varur në qafë. Tashmë paga e tij u rrit. U bë 110 lira.

***

Ishte shumë i përkushtuar dhe i kujdesshëm. Në fund të fundit, pronari nuk është budalla. Do ta vërejë menjëherë gatishmërinë e tij dhe për këtë mund të bëjë diçka. Ja, nëse, fjala vjen, do ta caktonte sekretar në fabrikë, sa mirë që do të ishte!
Sekretari merr 300 lira në muaj.
Kur njeriu dëshiron diçka me gjithë zemër, atëherë dëshira e tij i plotësohet.
Pronari e thirri Selametin në zyrën e vet:
- Jam i kënaqur me punën tënde - i tha. - Dua të bëj edhe diçka tjetër për ty. Natën pothuajse nuk bën asgjë. Mund ta mbash korrespondencën tonë? Do të të jap edhe 60 lira të tjera.
Selametit ishte gati t'i binte të fikët. Tani do të fitonte 170 lira...
Sekretari, i cili merrte 300 lira, u pushua menjëherë, se me bisedat, kafenë dhe cigaren, nuk i mbetej kohë për punë dhe në vendin e tij morën portierin tonë. Tani, ditën rrinte tek porta, kurse natën vinte para makinën e shkrimit dhe shkruante.

***

Punonte me gjithë shpirt. Në fund të fundit, pronari nuk është budalla. Herët a vonë do ta kuptojë gatishmërinë e tij dhe do ta shpërblejë. Llogaritari i fabrikës merrte 400 lira në muaj... ah, të mund të bëhej llogaritar!
Kur njeriu dëshiron diçka me gjithë zemër, atëherë dëshira e tij plotësohet.
Një ditë të bukur pronari e thirri Selametin në zyrën e vet:
- E di që sot 170 lira nuk janë asgjë - i tha. - Dua të ta rris rrogën.
- Faleminderit, bej efendi!
- Sigurisht që të mbetet mjaft kohë. Në vend që të rrish në shtëpi dhe ta shkosh kohën kot së koti, a mund ta mbash llogarinë e fabrikës?
- Mundem, bej efendi.
- Në rregull, do të marrësh edhe 45 lira të tjera.
Llogaritari i fabrikës, i cili merrte 400 lira në muaj, pasi në vend të shtesës, bëri ulje, madje edhe pjesëtim të shumëfishtë.
Tani Selameti merrte 215 lira në muaj. Gjashtë orë në ditë rrinte tek porta, tetë orë natën ruante fabrikën, duke punuar njëkohësisht në makinën e shkrimit dhe kur kthehej në shtëpi, rrëmbente llogarinë.

***

Lodhej jashtëzakonisht shumë, ishte i respektueshëm, mundohej të bënte më tepër nga ato që i kërkonin. Tani ëndërronte vendin e magazinierit. Magazinieri merrte 450 lira në muaj.
Kur njeriu dëshiron diçka me gjithë zemër, atëherë dëshira e tij plotësohet.
Një ditë pronari e thirri Selametin:
- Dua të bëj diçka për ty. Ç'do më thoshe, nëse të bëja magazinier?
- Do të ta dija për nder të madh, bej efendi.
- Në rregull. Do të të shtoj edhe 35 lira të tjera në pagën tënde. Eja të shkojmë në magazinë!
Magazinieri, një njeri tepër i pandërgjegjshëm, i cili e kishte bërë zakon të merrte sa më shumë gjëra nga fabrika në shtëpinë e tij, u pushua në çast dhe vendin e tij e zuri roja ynë i natës.

***

Punonte ditë e natë, pa llogaritur as lodhjen, as orët. Në fund të fundit, pronari ynë nuk është qorr, do ta vlerësojë vetëflijimin e tij. Dhe vërtet... pronari e thirri:
- Jam tepër i kënaqur me ty. Sa më shumë punon, aq më mirë ia del mbanë. Puna e portierit nuk të shkon. Do t'i mbash të gjitha punët e tjera dhe do të të bëj edhe drejtor të fabrikës.
Drejtor? Selametit ishte gati t'i binte të fikët. Prej kohësh e ëndërronte atë vend.
Kur njeriu dëshiron diçka me gjithë zemër, atëherë dëshira e tij plotësohet.
Ja ku u bë edhe drejtor!
- Do të shtoj 90 lira në pagën tënde - i tha pronari.
Përderisa pushoi së qeni portier, do t'i ulnin 80 lira nga paga. Por do të bëhej drejtor dhe do t'i jepnin 90 lira shtesë, domethënë do të kishte edhe 10 lira më tepër. Do të merrte 260 lira në muaj.
Ish-drejtori, i cili merrte 500 lira, u pushua menjëherë, pasi ngacmonte sekretareshën e pronarit.

***

Fabrika kishte 40 punëtorë, 2 kryepunëtorë dhe 20 makineri. Punëtor nuk mund të bëhej, nuk e dinte punën. As kryepunëtor, pasi nuk e njihte fare atë punë. Të punonte ai në vend të makinerive? Nuk bëhej.
Në zyrat e fabrikës, përveç tij, kishin mbetur vetëm pronari dhe sekretarja e tij.
Kur i mbetej pakëz kohë, bisedonte me sekretaren dhe t'i bënte elozhe pronarit.
- Zoti i dhëntë shëndet! Flori njeri! Hyra në fabrikë si portier me 80 lira në muaj.
Më bëri roje nate dhe më dha 110 lira. Më pas më bëri sekretar dhe ma ngriti pagën në 170 lira. Më emëroi llogaritar dhe filloi të më jepte 215 lira. U bëra magazinier dhe mora 250 lira. Tani jam drejtor dhe marr 260 lira.
Por edhe sekretaresha s'mbetej pas në elozhet e saj për pronarin.
- Erdha këtu si pastruese me 40 lira në muaj. Pastaj fillova të pastroja dhe të laja edhe shtëpinë e pronarit dhe më dha 60 lira. U bëra daktilografiste dhe paga ime u ngrit në 80 lira. Fillova të gatuaja dhe të ndihmoja në ekonominë e shtëpisë të pronarit dhe paga m'u bë 100 lira. Më pas, e dini, u bëra... dhe atëherë më dha edhe 15 lira të tjera. Kështu që tani marr 115 lira.
Një ditë Selameti i thotë sekretareshës:
- Punoni shumë, lodheni.
Sekretaresha iu përgjigj:
- Dhe ju mos pandehni se punoni më pak? Dhe nuk paguheni mirë. Sigurisht që do të donit shtesë.
Selameti e vështronte. U kujtua që në zyrat e fabrikës nuk kishte mbetur asnjë tjetër, përveç atyre të dyve. Mendoi detyrimet e vajzës...
- Jo, jo - tha. Nuk dua asnjë shtesë. Faleminderit shumë! Ah, sikur të isha grua... e dini se çfarë do të bëhej? Pronari do t'ju zbonte dhe do të më shtonte edhe 20 lira në pagën time... jo, jo... jam shumë i kënaqur... sikur të isha grua...

*(Përktheu: Iliaz Bobaj. Marrë nga revista "Akademia", nr. 7)*



**Erich FRIED**

## Status quo

*Kush do*
*Që bota*
*Të mbetet*
*Ashtu si është*
*Ai nuk do*
*Që bota të mbetet*

## Shembull i vogël

*Edhe jeta e pajetuar*
*Merr fund*
*Ndoshta më ngadalë*
*Se një bateri*
*Në një llambë dore*
*Që s'përdoret kurrë*

*Por kjo nuk ndihmon shumë:*
*Kur njeriu*
*(Supozojmë)*
*Pas vitesh të tëra*
*Do ta ndezë atë llambë ajo*
*Nuk nxjerr asnjë rreze drite*
*Dhe nëse ti e ndez atë*
*Has vetëm në kockat e tua*
*E nëse nuk ke fat*
*Edhe ato*
*Do të jenë të brejtura*

*Ndërkaq që ti*
*Po aq mirë*
*Do të mund të kishe ndriçuar*

## Një parakusht shtesë

*Nuk është*
*Vetëm e rëndësishme*
*Që një njeri*
*Të mendojë drejt*

*E rëndësishme është*
*Gjithashtu*
*Që ai që mendon drejt*
*Të jetë njeri*

*(Përktheu: Ismet Daci. Marrë nga revista "Akademia", nr.7)*

E jashtëzakonshme

# Iluzionisti amerikan ngjitet në mbi 7 mijë metra lartësi me balona të mbushur me helium




Iluzionisti/magjistari David Blaine është ngritur mbi 7 000 metra lartësi mbi shkretëtirën e Arizonës, duke qëndruar i varur në balona. 47-vjeçari realizoi "një akrobacion" në Arizona të ShBA-së, që u transmetua drejtpërdrejt në "YouTube", ku shihet Blaine duke qëndruar në mbi 7 000 metra lartësi, ku me ndihmën e 52 balonave të mbushur me helium qëndronte në ajër.

## BARSOLETA E DITËS



Vajza: Mami, sot u përgjigja e para në mësim.
Mami: Të lumtë bija e mamit, po cila ishte pyetja?
Vajza: Kush ka ardhur pa përgatitur?

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

FOTO E DITES




Kriporja e Nartës në Vlorë. /Foto: LSAPHOTO.COM/



E rrallë

# Filmohet burri në Nju-Jork duke qëndruar i varur në pjesën e pasme të një autobusi

Një burrë në ShBA është filmuar duke qëndruar i varur nga jashtë, në pjesën e pasme të një autobusi që ishte në lëvizje. Videoja është shpërndarë në "Instagram", ku shfaq një pasagjer të veshur me të zeza që qëndron në mbrojtësin e pasmë të autobusit dhe mbahet në sistemin e ventilimit.



**DASHI**
Ju do të keni shanse të shkëlqyera për ta rimarrë situatën emocionale dhe për të rinovuar dashurinë tuaj.



**DEMI**
Njerëzit e kësaj shenje do të duhet të pranojnë idenë se personi pranë tij nuk është gjithmonë i sinqertë.



**BINJAKËT**
Për ta shmangur zhgënjimin, mos e teproni dhe mos dëmtoni ndjeshmërinë e të dashurit tuaj i cili nuk udhëton gjithmonë në të njëjtën gjatësi vale si ju.



**GAFORRJA**
Pak pushim, heshtje, do të ndihmojë në rivendosjen e ekuilibrit të brendshëm i cili është mjaft i nevojshëm.



**LUANI**
Nëse doni të merrni më shumë nga partneri juaj, do të duhet të bëni disa premtime në këmbim. Siç e dini mirë, duhet të jepet për të marrë.



**VIRGJËRESHA**
Më në fund gjithçka do të jetë e qartë pas një sherri me partnerin tuaj. Një letër ose një fjalim i sinqertë konfirmon qëllimet tuaja.



PESHORJA
Nëse lundroni në pasiguri, kjo ditë ju ofron kohën dhe rrethanat e nevojshme për të sqaruar një çështje familjare, ndoshta një çështje që ka të bëjë me financat.



AKREPI
Lejoni vetes një çast pushimi. Hidhni gjithçka mbrapa dhe organizoni një udhëtim ose një lëvizje të thjeshtë në një vend të qetë.



**SHIGJETARI**
Fantazia dhe imagjinata do të jenë aleatët tuaj në krijimin e një marrëdhënie më të ndritshme dhe më tërheqëse.



**BRICJAPI**
Ju mund t'i kushtoni një pjesë të kohës suaj në kuzhinë për t'u përgatitur të gjithëve një drekë të këndshme të së dielës.



**UJORI**
Ju duhet pak më shumë optimizëm për ta përballuar ditën në një mënyrë pozitive. Sot keni një prirje të caktuar për t'u akorduar me ngjyrën gri.



PESHQIT
Ndryshimet e njoftuara tashmë nga yjet më në fund mund të bëhen të vërteta. Në sferën emocionale, duhet t'i keni kapërcyer të gjitha dyshimet.

# “City of angels”, po vjen nga Seven Saraçi



Seven Saraçi ka paralajmëruar një këngë të re të cilën do ta sjellë të shoqëruar edhe me videoklip. “City of angels” mban titullin kënga e re e Sevenit, e cila do të publikohet pas tri ditësh në kanalin “YouTube”. “Best friend” titullohet kënga e fundit nga Seven Saraçi, kurse fansave u mbetet të presin e të shohin se çfarë ka përgatitur këtë herë ai.

# Fjolla Morina arrin një milion klikime në këngën “Kape”



Këngëtarja e njohur shqiptare Fjolla Morina njihet për veprimet e saj që marrin gjithmonë vëmendje në rrjet. Bukuroshja është aktive në rrjete sociale, duke ndarë kështu imazhe të ndryshme nga përditshmëria dhe udhëtimet. Së fundmi, në një postim në rrjetin social “Instagram”, Fjolla ka ndarë një imazh provokues, ndërsa falënderon fansat për pëlqimin e këngës së re. “Një milion klikime në më pas se dy ditë, faleminderit”, ka shkruar ajo në përshkrimin e imazhit.




# Dafina Zeqiri shton edhe një tatuazh në trup

Edhe pse numëron disa të tilla në pjesë të ndryshme të trupit, Dafina Zeqiri vazhdon të realizojë ende të tjera. Kështu veproi edhe së fundi teksa publikoi një video gjatë procesit kur po bënte një tjetër tatuazh në trup, por që pastaj nuk e tregoi rezultatin e saj. Dafina së fundi ka zgjedhur të pushojë disa ditë në bregdetin shqiptar, kurse po shijon suksesin e këngëve të fundit. “Million dollar” titullohet projekti i ri nga Dafina, këngë e cila u prit shumë mirë në publik.

# Është martuar, por Justini ende përmend emrin e Selenës në këngë





“Look, Ariana, Selena, my Visa”, thotë Justini në një varg të këngës, e kjo ngjalli shumë debate mes fansave të Justinit dhe Selenës. Selena Gomezi është shumë e zënë me promovimin e linjës së saj të re ‘Rare Beauty’ dhe ndoshta nuk i ka rënë në sy kënga e re e ish-partnerit të saj Justin Bieberit. Edhe pse nuk ka asgjë të keqe me tekstin, por duke marrë parasysh marrëdhënien e Justinit dhe Selenës, e cila është cilësuar edhe nga të dy ata, si emocionalisht abuzive, disa njerëz nuk e pritën edhe aq mirë. Para marrëdhënies së Justinit me modeluesen Hailey ai kishte një histori të gjatë romantike me Selenën.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Njohësit e futbollit: Berisha kishte të drejtë në reagimin ndaj Challandesit



Sjellja e Bernard Berishës pas golit të shënuar ndaj Greqisë në opinionin futbolldashës në Kosovë ishte normale për faktin se atij nuk i është dhënë rasti të luajë përgjatë dy vjetëve të fundit. "Berisha asnjëherë nuk është ankuar që nuk ka minuta për të. Ju keni ndërruar plot lojtarë në ato pozicione dhe Berishës nuk i keni dhënë asnjë minutë. Djali luan në një kampionat shumë të fortë dhe është duke bërë një sezon shumë të mirë, kurse sot tregoi që ka të drejtë", ka thënë Shpëtim Babaj

"Epoka e re"

Prishtinë, 7 shtator - Futbollistit Bernard Berisha për dy vjet nuk iu dha mundësia të paraqitet asnjë minutë, por ai vendosi të heshtë. Ndërsa në ndeshjen me Greqinë, Berisha u inkuadrua në lojë dhe shënoi gol, por kjo nuk ishte e gjitha, për faktin se mesfushori ofensiv, pas shënimit, bëri një festim të çuditshëm në drejtim të trajnerit Bernard Challandes. Pas ndeshjes Berisha mohoi ta ketë bërë për trajnerin, por e pranoi se gjatë dy vjetëve të fundit ka vuajtur shumë, derisa ka thënë se është i gatshëm t'i respektojë gjithmonë vendimet e trajnerit. "Nuk kishte të bëjë drejtpërdrejt me trajnerin, por dy vjet asnjë minutë s'kam luajtur në ndeshje zyrtare. Ndoshta dikush e ka marrë për trajnerin, por unë e kam bërë vetëm për atë që s'e kam pasur minutazhën e duhur. Por, prapë vendos trajneri. Për formacion vendos trajneri. Do të jem i gatshëm gjithmonë. Nëse mendon trajneri se gjesti është bërë për të, unë i them qysh tani që mos të më ftojë për shkak të mosdisiplinës. U kërkoj falje tifozëve, por vetëm unë e di sa kam vuajtur. Unë e kam pranuar Kosovën pa asnjë kusht dhe sot nuk kam asnjë kusht. Njerëzit e tjerë vlerësojnë a më është bërë padrejtësi. Kam vuajtur shumë në këto dy vjet", ka thënë Berisha.

Reagimi i trajnerit Challandes ishte i ashpër në raport me sjelljen e futbollistit nga Peja. Trajneri zviceran ka thënë se nuk toleron sjellje të tilla. "Ishte mesazh për mua. Nuk e pranoi këtë mënyrë festimi. Ti më tregove që je këtu, je pjesë e ekipit, nuk kemi nevojë për asi festimi. Unë jam trajneri. S'mund ta pranoj këtë lloj festimi", ka thënë Challandes.

Ndërsa trajneri i njohur në Kosovë, Ismet Munishi, e ka porositur Berishën që me punë t'ua mbyll gojën të gjithëve. "Je djali më i mirë ndër të gjithë lojtarët. Nuk fole kurrë që dy vjet. Të kanë injoruar e diskriminuar. Mbyllua gojën me gola dhe me punë, se me punë ke ardhur këtu ku je. Je në superformë Bernard. Sot u tregove të gjithëve se meriton të luash. Për Kosovën duhet të luajnë lojtarët që janë në formën më të mirë momentale. Nuk guxojmë të bëjmë eksperimente. Respekt për të gjithë lojtarët e Kosovës, por ata duhen menaxhuar në mënyrë të drejtë", ka deklaruar trajneri i Ballkanit.

Ndërsa ish-futbollisti i njohur që bëri karrierë në Kosovë e Shqipëri, Shpëtim Babaj, i ka dhënë të drejtë Berishës për sjelljen pas golit të shënuar ndaj grekëve. "Berisha asnjëherë nuk është ankuar që nuk ka minuta për të. Ju keni ndërruar plot lojtarë në ato pozicione dhe Berishës nuk i keni dhënë asnjë minutë. Djali luan në një kampionat shumë të fortë dhe është duke bërë një sezon shumë të mirë, kurse sot tregoi që ka të drejtë. Reagimi i tij i papranueshëm, por edhe ai ka gjak nëpër vena. Në qoftë se je trajner, nuk do të thotë që nuk gabon, por pranoje dhe thuaj kam gabuar me Berishën", ka thënë Babaj.

Ndërsa lidhur me rastin në fjalë ka reaguar edhe menaxheri i Bernard Berishës, Shkumbin Qormemeti, i cili ka uruar që përzgjedhësi i Kosovës ta ketë kuptuar se kush është Berisha. "Uroj që trajneri Challandes ta ketë kuptuar kush është Bernard Berisha", ka shkruar Qormemeti.

## SHKURT

### Mici konfirmon transferimin te Prishtina

Mbrojtësi i majtë, Gledi Mici, e ka konfirmuar se do t'i bashkohet skuadrës së Prishtinës. Pas Sabien Lilajt, bardhekaltrit kanë bërë edhe goditjen tjetër të madhe, duke forcuar këtë radhe repartin e mbrojtjes. "Po, mund të konfirmoj se jam futbollist i Prishtinës. Kemi arritur marrëveshje njëvjeçare me kryesinë e klubit dhe në edicionin e ri do ta vesh fanellën e Prishtinës", ka deklaruar Mici për "Olle". Mici në edicionin e kaluar djersiti fanellën e Shkëndijës.

### Hadërgjonaj: Shpejt vendos për të ardhmen

Florent Hadërgjonaj mund të transferohet në Greqi te skuadra e Olympiacosit. Ai ka dhënë sinjale se e ardhmja e tij do të zgjidhet brenda pak ditëve. "Jemi në bisedime me disa klube. Shpresoj që të kryhet sa më shpejt dhe të punoj që të jem gati për muajin e ardhshëm, të jem i gatshëm kundër Maqedonisë. Shpresoj që në javën tjetër të kryhet gjithçka", ka thënë Hadergjonaj për "Supersport".

### Debutim i suksesshëm për Zogajn në Danimarkë

Hendbollistja e re e Kosovës, Njoma Zogaj, ka luajtur të dielën ndeshjen e parë zyrtare në nivelin e të rriturave. Ajo u paraqit për skuadrën EH Aalborg që fitoi 32:18 ndaj Gudme HK. Zogaj luajti rreth dhjetë minuta, kurse shënoi dy gola. EH Aalborg garon në kategorinë e dytë daneze, ku paraqiten edhe disa reprezentuese të Kosovës. "Mendoj se kam pasur paraqitje të mirë. I kisha edhe katër asistime, ndërsa e kam siguruar një penallti. Po ashtu, kam luajtur mirë në mbrojtje. Isha në mes në mbrojtjen 5:1", ka thënë Zogaj për faqen zyrtare të Federatës së Hendbollit të Kosovës.

### Motrat Hajdari me fitore e nisin edicionin e ri në Danimarkë

Me fitore edicionin e ri në Danimarkë e kanë filluar edhe motrat Marigona e Arlinda Hajdari. Ato kanë dhënë kontribut të çmueshëm në derbin e xhiros së parë të kategorisë së dytë, në mes të Ringkobingut dhe Sonderjyskes. Ringkobingu fitoi me rezultat 29:21. Sonderjyskes po i mungon shumë kapitenia e Kosovës dhe liderja e kësaj skuadre, Leonora Demaj. Ajo është në fazë rikuperimi pas operimit të gjurit. Motrat Hajdari po rriten vazhdimisht si lojtare dhe presim të ofrojnë kontribut të madh edhe në Përfaqësuesen e Kosovës.

## Aliti: Na munguan tifozët, muajin tjetër e bëjmë ëndrrën realitet

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kosova ka pësuar humbjen e parë në edicionin e ri të Ligës së Kombeve. 'Dardanët' janë mposhtur në Prishtinë me rezultat 1-2 nga Greqia, në stadiumin "Fadil Vokrri".

Mbrojtësi Fidan Aliti u është drejtuar tifozëve nëpërmjet një postimi në "Instagram". "Të dashur tifozë, e ndiej obligim t'ju drejtohem të gjithëve pas ndeshjes me Greqinë. E di që kjo ndeshje nuk ishte siç kemi pasur dëshirë ne lojtarët dhe ju tifozët. Përfundimisht, përkrahja juaj na mungoi në tribunat e stadiumit, që ishte bosh. Dihet që me ju, 'Dardanët', ne jemi më të fortë. Ne jemi kombëtare e vogël dhe duhet të mësojmë prej këtyre ndeshjeve që na bëjnë më të fortë. Ne po rritemi së bashku dhe shihemi muajin tjetër për ta bërë ëndrrën realitet. Përgjithmonë 'dardan'", ka shkruar Aliti.



# Teuta Abdullahu: Basketbolli është jeta ime

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Një nga basketbollistet e Gjeneratës së Artë të Universitetit të Prishtinës është Teuta Abdullahu. Ajo ka dhënë kontribut në basketbollin e femrave në Kosovë. Teuta në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së ka treguar si filloi të merret me basketboll, cila është ndeshja që nuk e harron, trofeun më të veçantë, kundërshtaren më të vështirë dhe mesazhin për vashat e reja që duan të merren me basketboll.



*Si vendose të luaje basketboll?*
Që në fëmijëri kam shprehur interesim për sportin në përgjithësi, por karrierën sportive e fillova në tenis. Shumicën e kohës e kaloja në fushat e tenisit pranë shkollës "Ismail Qemaili", mirëpo edhe basketbolli ishte pjesë e imja gjatë kësaj kohe, pasi në çdo kohë të lirë isha duke luajtur basketboll te lagjja ime. Pas përfundimit të luftës në vitin 1999 ishte Qemail Leti, shoku i babait, në atë kohë udhëheqës i KB Universitetit, i cili një natë më pyeti nëse kisha dëshirë t'i bashkohem KB Universitetit që ta provoja veten. Në atë moment filloi karriera ime basketbollistike, por që vitin e parë luaja të dy sportet, tenisin dhe basketbollin, derisa e gjeta veten që po ndihem më mirë me basketboll dhe me skuadrën që më kishin pritur tej mase mirë, për të cilën dua t'i falënderohem pos anëtarëve të kryesisë dhe trajnerit Blerim Krasniqi, vajzave Albulena Bylykbashi, Elvira Dushku, Doruntina Vuniqi, Vlora Krasniqi dhe Vlora Braha, të cilat me konsideronin si motrën e vogël.

*Cili ka qenë idhulli yt në fëmijëri?*
Idhulli im në atë kohë ishte Micheal Jordan në basketboll dhe Monika Seles në tenis.

*Cili ka qenë trofeu më i rëndësishëm për ty dhe pse?*
Trofeu më i rëndësishëm për mua personalisht ishte Kupa e Kosovës në vitin 2005, në të cilën ndeshje e kemi fituar me rezultat shumë të ngushtë. Ky ishte trofeu im i parë si kapitene e skuadrës, prandaj ky sukses ka rëndësinë e veçantë për mua.

*Cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë?*
Gjatë karrierës sime ka shumë ndeshje që nuk mundem t'i harroj asnjëherë, por përveç ndeshjes kur fituam trofeun që e përmenda, e kisha veçuar ndeshjen nga pjesëmarrja në Trocal League, ndaj Lek Jezica, ku në këtë ndeshje kisha minutazhën më të lartë gjatë tërë sezonit dhe njëherësh kisha arritur që në prani të publikut kosovar të tregoja lojë të mirë.

*Cila ka qenë kundërshtarja më e vështirë që je ballafaquar?*
Në Trocal League kishim kundërshtarë të fortë në përgjithësi për të cilën nuk kisha veçuar ndonjë specifik, sepse vet liga kishte konkurrencë të nivelit të lartë, ndërsa në Ligën e Kosovës kundërshtarin më të fortë e kemi pasur KB Bashkimi nga Prizreni. Ballafaqimet me vajzat e KB Bashkimit kanë qenë çdo herë me emocione dhe kujtime, të cilat ende më përcjellin sa herë shkoj për ta vizituar qytetin e Prizrenit.

*Sa të mungon basketbolli dhe atmosfera nga koha kur ke luajtur?*
Unë jam rritur me basketboll dhe palestra është vendi ku unë ndihem krejtësisht vetvetja dhe ku mbushem me energji. Më mungon shumë koha kur basketbollin e kisha prioritet të jetës, mirëpo me kalimin e kohës prioritetet në jetë po ndryshojnë. Tani kam vajzën Hanën, e cila plotëson çdo gjë për mua, por asnjëherë nuk jam larguar tërësisht nga basketbolli, e gjej çdo hapësirë të mundshme dhe sado pak kohë për basketboll.

*Cili është mesazhi për lojtaret e reja që duan të merren me basketboll?*
Për të gjitha vashat e reja të cilat duan të merren me basketboll, tani kanë shumë më tepër mundësi për tu prezantuar dhe treguar veten ndërkombëtarisht, prandaj le ta shfrytëzojnë këtë mundësi për të luajtur dhe shkolluar. Basketbolli kërkon përkushtim dhe disiplinë gjë që të përgatit për sfidat e ndryshme që të presin gjatë jetës dhe periudha të ndryshme.

## SHKURT

### Presidenti i Veronës: Kumbulla është futbollist për 10 ekipet më të mira në botë

Presidenti i Veronës, Maurizio Setti, së fundmi ka folur për të ardhmen e Marash Kumbullës. Në një intervistë për gazetën "QS", numri 1 i Veronës ka pranuar se në drejtim të klubit kanë ardhur shumë oferta për talentin shqiptar, i cili ka shpërthyer me paraqitjet në sezonin e fundit të Serisë A. "Na kanë mbërritur shumë oferta, të gjitha nga klubet elitare. Ne kemi besuar gjithmonë tek aftësitë e Kumbullas dhe kemi refuzuar oferta të rëndësishme kur lojtari ka qenë pjesë e skuadrës Primavera. Si profil dhe për mënyrën sesi sillet në fushë, Marash Kumbulla është një lojtar për 10 skuadrat më të mira në botë", deklaroi Maurizio Setti. Në ditët e fundit ka pasur një ofertë konkrete nga Lazio, por Verona deri më tani ka bërë rezistencë, duke hedhur poshtë çdo propozim.

### Lojërat Olimpike do të zhvillohen në vitin 2021

Lojërat Olimpike, që ishin parashikuar për t'u zhvilluar gjatë verës së vitit 2020, do të zhvillohen gjatë vitit të ardhshëm për shkak të situatës me Covid-19. Këtë të hënë është marrë vendimi që Lojërat Olimpike të nisin më 23 korrik 2021 dhe do të zgjasin deri më 8 gusht.
Nënkryetari i Komitetit Olimpik, John Coates, është shprehur se Lojërat Olimpike do të zhvillohen verën e ardhshme, edhe nëse situata me Covid-19 do të vijojë të jetë e njëjtë. Coates konfirmoi se Lojërat Olimpike do të fillonin më 23 korrik të vitit të ardhshëm, duke i quajtur "Lojërat që pushtuan COVID-in". Më tej ai u shpreh se tashmë ka dritë në fund të tunelit dhe garat do të zhvillohen. Më herët në muajin korrik shefi ekzekutiv i "Tokyo 2020", Toshiro Muto, ka thënë se po mendohet që gjatë zhvillimit të lojërave olimpike do të ketë një audiencë të kufizuar, pasi është përjashtuar mundësia që të zhvillohen pa asnjë spektator.

### Mahrez dhe Laporte infektohen me Covid-19

Manchester City ka konfirmuar se testet e Riyad Mahrez dhe Aymeric Laportes tregojnë se janë bartës të koronavirusit. Sikurse e kërkon protokolli, të dy lojtarët do t'i nënshtrohen një periudhe vetizolimi. Klubi anglez konfirmoi se asnjëri nga lojtarët nuk po tregon ndonjë simptomë të virusit. Premierë Liga rinis këtë të shtunë, teksa skuadra e Pep Guardiolës udhëton në "Molineux", për t'u ndeshur me Wolves për hapjen e sezonit më 21 shtator, por pas infektimit me Covid-19 të dy lojtarëve të Citizensit, gjithçka është në dyshim. "Manchester City mund të konfirmojë që Riyad Mahrez dhe Aymeric Laporte kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Të dy lojtarët aktualisht janë në vetizolim në përputhje me protokollin e Premierë Ligës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Ata nuk kanë simptoma të virusit. Të gjithë në klub u urojnë Riyad dhe Aymeric shërim të shpejtë përpara kthimit të tyre në stërvitje për sezonin e ri", thuhet në njoftimin e Cityt.

# Milwaukee fiton dhe mbetet në lojë ndaj Miamit, fitojnë edhe Lakersat

ORLANDO, 7 SHTATOR - Milwaukee Bucksi tregoi gjithë krenarinë duke fituar në shtesë 118-115 ndaj Miami Heatit, sukses që mbajti në lojë skuadrën nga Wisconsi në serinë e gjysmëfinaleve pasi Milwaukee ngushtoi shifrat në 1-3. Lajmi i keq për Bucksin ishte dëmtimi i Giannis Antetokounmpos në kyçin e këmbës, raporton "Supersport".
Ylli i NBA-s ishte në dyshim për këtë përballje për shkak të përdredhjes së kaviljes së djathtë, ndërsa në fillim të periodës së dytë vendosi keq këmbën duke u rrëzuar në parket mes dhimbjesh. Antetokounmpo në më pak se 12 minuta lojë kishte mundur të shënonte plot 19 pikë. Ai ekzekutoi dy gjuajtjet e lira që fitoi, por e pati të pamundur për të vijuar më tej. Pas një ndeshjeje shumë të ekuilibruar, shokët e tij të ekipit mund të fitonin në shtesë 118-115, duke rihapur serinë kundër Heat. Performancë e shkëlqyer e Chis Middletonit, autor i 36 pikëve, 8 "reboundeve" dhe 8 asistimeve në 48 minuta lojë. Duke pasur parasysh mungesën e detyruar të Antetokounmpos, ai u kthye pikë referimi për Bucksin. Për Miamin nuk mjaftuan 26 pikë, 12 "rebounde" dhe 8 asistime të Bam Adebayo për të fluturuar më herët në finalen e Konferencës



Lindore.
Los Angeles Lakersi iu kundërpërgjigj me fitore 117-109 Houston Rocktesit në përplasjen e dytë të serisë në gjysmëfinalet e Perëndimit. Një përballje e luftuar që mori rrjedhë nga një kosh i LeBron Jamesit, 32 sekonda para rënies së sirenës. Shënuesi më i mirë për kalifornianët rezultoi Anthony Davis me 34 pikë, 10 "rebounde" dhe 4 asistime, ndërsa LeBron Jamesi për pak regjistroi "triple double", duke e mbyllur takimin me 28 pikë, 11 rikuperime dhe 9 asistime në 39 minuta mbi parket.

## Republika e Kosovës
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3107/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## Republika e Kosovës
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3114/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## Republika e Kosovës
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3108/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## Republika e Kosovës
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3110/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3111/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3113/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3112/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 3109/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:062968
Datë: 07.07.2020
Numri i dokumentit: 01012299

**C.nr.162/2020**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,** Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i përbërë nga gjyqtari i vetëm **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësit Gzim Zeqir Krasniqi nga Rahoveci Rr. "Hamdi Berisha" p.n. të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Myhedin Bekeri nga Rahoveci, kundër të paditurës Mërvete Zeqir Krasniqi nga Rahoveci, tani e shpërngulur në shtete e jashtme me adresë të pa njohur, për shkak të zgjidhjes së martesës, me dt.**07.07.2020**, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**Të paditurës Mërvete Zeqir Krasniqi nga Rahoveci, tani e shpërngulur në shtetet e jashtme me adresë të pa njohur, I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm avokat Gazmend Sharku nga Rahoveci.**

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

**A r s y e t i m**

Paditësi Gzim Zeqir Krasniqi nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Myhedin Bekeri nga Rahoveci, ka ushtruar padi zgjidhjes së martesës kundër të paditurës Mërvete Zeqir Krasniqi nga Rahoveci, tani e shpërngulur në shtetet e jashtme me adresë të pa njohur.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se e paditura është e shpërngulur në botën e jashtme dhe përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka propozuar që në këtë çështje kontestimore të caktojë një përfaqësues të përkohshëm që i njëjti t'ia mbrojë të drejtat deri sa të paraqitet në gjykatë vetë e paditura respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën për caktimin e kujdestarit.

Duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurës dhe se përfaqësuesi i përkohshëm av. Gazmend Sharku nga Rahoveci, është pajtuar që ta përfaqësojë të paditurën e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.

1 (2)

Numri i lëndës: 2020:062968
Datë: 07.07.2020
Numri i dokumentit: 01012299

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË– DEGA NË RAHOVEC,**
**C.nr. 162/2020, me datë 07.07.2020**

**Gjyqtari**
**Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:014985
Datë: 21.08.2020
Numri i dokumentit: 01073116

**C.nr.668/2019**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,** Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i përbërë nga gjyqtari i vetëm **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësit Zenel Sokol Gashi nga fshati Bratotin, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Myhedin Bekeri nga Rahoveci, kundër të paditurit Shaban Mustafë Gashi fshati Bratotin, Komuna e Rahovecit, tani gjendet në Zvicër, me adresë të pa njohur, për shkak të dorëzimit të pjesës së paluajtshmërisë, me dt.**21.08.2020**, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**Të paditurit Shaban Mustafë Gashi fshati Bratotin, Komuna e Rahovecit, tani e shpërngulur në shtetet e jashtme – Zvicër, me adresë të pa njohur, I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm avokat Zyber Zeka nga Rahoveci.**

**Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.**

**Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.**

**A r s y e t i m**

Paditësi Zenel Sokol Gashi nga fshati Bratotin, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Myhedin Bekeri nga Rahoveci, ka ushtruar padi për shkak të dorëzimit të pjesës së paluajtshmërisë, kundër të paditurit Shaban Mustafë Gashi fshati Bratotin, Komuna e Rahovecit, tani gjendet në Zvicër, me adresë të pa njohur.

Gjÿkata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se e paditura është e shpërngulur në botën e jashtme - Zvicër dhe përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka propozuar që në këtë çështje kontestimore të caktojë një përfaqësues të përkohshëm që i njëjti t'ia mbrojë të drejtat deri sa të paraqitet në gjykatë vetë i padituri respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën për caktimin e kujdestarit.

Duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit dhe se përfaqësuesi i përkohshëm av. Zyber Zeka nga Rahoveci, është pajtuar që ta përfaqësojë të paditurën e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.
Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË– DEGA NË RAHOVEC,**
**C.nr.668/2019, me datë 21.08.2020.**

**Gjyqtari**
**Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

▶ Argjenta Beqiraj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik të UP-së, Prishtinë.

▶ Enver Kelmendi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Viktor Shtufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Zef Lush Marku " Velezh.

▶ Xhemajli Berisha shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Mirsada Idrizi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Edon Hoda shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Luigj Gurakuqi " Nashec.

▶ Albert Demiraj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

▶ Enes Badalla shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Deshmoret e Zhurit " Zhur.

▶ Besim Mehmeti shpall të pavlefshëm ID-në me nr. RE-6502/17 të Fakultetit Infermieri e përgjithshme të Universitetit AAB.

▶ "Art-Eda" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330373465

▶ Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehje qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.